



Dardania 4/7 lam. D-2 tel++381/38550 834, 548 326, fax: 548 327
E-mail HANDIKOS@ipko.org

HandiKOS-i është Organizatë jo-qeveritare e personave dhe për personat me aftësi të kufizuar që vepron në tërë territorin e Kosovës.

Është themeluar në vitin 1983 si shoqatë e paraplegjikëve dhe paralizës së femijëve të Kosovës, ndërsa pas luftës është emëruar si HandiKOS, dhe për qëllim ka përmirësimin e standardit jetësor dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri.

VIZIONI

Një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje të plotë të të drejtave dhe krijimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuar.

MISIONI

Promovimin, parandalimin e aftësisë së kufizuar, ofrimin e shërbimeve si dhe njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të PAK

- **Ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të barabartë** përmes: Fuqizimit të zërit, ndërtimit dhe zhvillimit të strukturave përfaqësuese të PAK.

Avokimit, Lobimit dhe ndikimit në politikat koherente zhvillimore të Kosovës, në përfshirjen e të drejtave dhe nevojave të PAK duke u bazuar në standardet Kombëtare/Ndërkombëtare.

- **Në përmirësimin e standardit jetësor të PAK** përmes:
Trajnimit, aftësimin, punësimin dhe programeve ekonomike
Përfshirjen e PAK në skemat e mirëqenies sociale dhe sigurisë sociale,
Ndikimit në qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve publike

- **Qëndrueshmërinë e HANDIKOS-it** përmes:
Mobilizimit dhe angazhimit të përkrahësve vullnetarë,
Njohjen e shërbimeve të rehabilitimit primar në bashkësi të organizuara dhe ofruara nga HANDIKOS-i
Organizimit të programeve fitimprurëse.

**SHËRBIMET E REHABILITIMIT
TË BAZUARA NË BASHKËSI
RBB**

UDHËZUES PËR QYTETARËT
DHE INSTITUCIONET

Prishtinë, Kosovë
2005

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	4
1. Parathënie	5
2. Përmbledhje	6
II. Shërbimet e rehabilitimit të bazuara në bashkësi	8
1. Skenari ndërkombëtar për çështjen e aftësisë së kufizuar	8
• Dokumentet e KB	8
2. RBB-ja në botë	11
• Dokumentet	11
• Politikat dhe strategjitë për RBB-në	11
3. Skenari kombëtar	14
• Dokumentet mbi RBB-në	
4. Legjislacioni aktual me influencë në RBB	16
5. RBB-ja në Kosovë	25
a. HandiKOS-i para luftës së vitit 1999	25
b. HandiKOS-i gjatë luftës	27
c. HandiKOS-i pas luftës së vitit 1999	27
• Kuadri	31
• Ndërtimi i kapacitetit / trajnimet	34
• Infrastruktura dhe pajisjet	36
• Aktivitetet dhe të arriturat	37
• Analiza / hulumtime rreth gjendjes së PAK-ve në Kosovë	41
III. Vizioni për të ardhmen	42
• Rishqyrtimi i pjesës së dytë të broshurës	42
• Korniza logjike e strukturave të RBB-së	44
• Strukturat e RBB-së	45
IV. Shtojcat	48
Shtojca 1. Numri i përgjithshëm i PAK	48
Shtojca 2. Vizitat mjekësore të fëmijëve në qendrat e bashkësisë	49

Bibliografia

Shkurtesat:

RBB	–	Rehabilitimi i bazuar në bashkësi
OBSH	–	Organizata botërore e shëndetësisë
ILO	–	Organizata ndërkombëtare e punës (jetesës)
UNESCO	–	Organizata e kombeve të bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë
UNICEF	–	Fondacioni i kombeve të bashkuara për fëmijë
SHPPFK	–	Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës
KB	–	Kombet e Bashkuara
OJQ	–	Organizatë joqeveritare
OPAK	–	Organizata e personave me aftësi të kufizuar
OJQN	–	Organizata ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuar
HI	–	Handicap International
OXFAM	–	Organizatë humanitare nga Britania e Madhe
DANIDA	–	Agjencioni danez për zhvillim ndërkombëtar
ICACBR	–	Qendra ndërkombëtare për avancimin e rehabilitimit të bazuar në bashkësi
DSI	–	Organizatë e personave me aftësi të kufizuar nga Danimarka
FIDIDA	–	Agjencia ndërkombëtare e aftësisë së kufizuar e Finlandës
PAK	–	Persona me aftësi të kufizuar
CIMIC Gjerman	–	Bashkëpunimi civil ushtarak Gjerman
SAH Zvicëran	–	Organizatë zviceriane
KFOR	–	Forcat paqëruajtëse të NATO-s në Kosovë
USAID	–	Agjencioni i SHBA-ve për zhvillim ndërkombëtar
SHBA	–	Shtetet e bashkuara të Amerikës
DELTA	–	Edukimi zhvillimor dhe ekipet udhëheqëse në veprim
SIND	–	Shoqatë për persona me çrregullime mendore nga Danimarka
Gravir-aslb	–	Grup multidiciplinar që merret me studime dhe zhvillime të modeleve të rehabilitimit të përgjithshëm; shoqatë e cila drejton rrjetin e institucioneve evropiane rehabilituese dhe aftësuese në Belgjikë, Francë dhe Zvicër
Save the Children UK	–	Save The Children nga Mbretëria e Bashkuar
Onlus Don Gnocchi	–	Organizatë Italiane
EAR	–	Agjencioni evropian për rindërtim
FDI	–	Fondacioni për iniciativa demokratike
KNAP	–	Projekti i avokimit të OJQ-ve të Kosovës
OSBE	–	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë

I. HYRJE

I. HYRJE

1. Parathënie

Rehabilitimi institucional nuk mund ti mbulojë të gjitha nevojat e personave me aftësi të kufizuar. Në formën ekzistuese të organizimit dhe nivelit të shtrirjes, rehabilitimi institucional nuk u mundëson qasje në shërbime rehabilituese shumicës së personave me aftësi të kufizuar dhe nga ana tjetër i bën ato shumë të shtrenjta për arsye se personat me aftësi të kufizuar duhet të udhëtojnë në mënyrë që ti shfrytëzojnë këto shërbime. Këto janë disa nga parametrat që flasin se përmes shërbimeve rehabilituese institucionale mbulimi i nevojave është i kufizuar në një përqindje të vogël të popullatës.

Fakti që rehabilitimi institucional është treguar jo i efektshëm që ti mbulojë të gjitha nevojat e personave me aftësi të kufizuar nga njëra anë si dhe çmimet e larta të shërbimeve të ofruara dhe praktikat segreguese nga ana tjetër e kushtëzojnë nevojën e njohjes dhe zhvillimit të shërbimeve të rehabilitimit të bazuar në bashkësi (RBB).

RBB-ja ka për qëllim të përfshijë të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe të ndikoj në organizimin e jetës së tyre përmes intervenimit rehabilitues. Iniciativat e RBB-së fuqizojnë konceptin e dhënies së mundësive atyre që janë të përfshirë në procesin e rehabilitimit veçanërisht shfrytëzuesve të shërbimeve. Në RBB, nevojat esenciale rehabilitues janë ato për rehabilitim fizik, psikomotorik si dhe parandalimi.

Që të arrijë rezultatet e dëshiruara RBB-ja siguron shërbime me çmim më të ulët që nënkupton transferimin dhe ndarjen e resursve, dhe shkathtësive me shfrytëzuesit përfundimtarë të shërbimeve përmes rrjetit të njohur si Rehabilitim i Bazuar në Bashkësi.

Rezultatet e shërbimeve të RBB-së:

Përmirësimi i kualitetit të jetës së personave me aftësi të kufizuar përmes rritjes së shanseve dhe mundësive të jetës, duke rritur nivelin e autonomisë fizike dhe sociale të tyre dhe duke siguruar mundësi të barabarta për qasje në shërbime adekuate.

I. HYRJE

2. Përmbledhje

Kjo broshurë është pjesë e projektit të HandiKOS-it "Përmirësimi i gjendjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike dhe gjinore" 2004.

Qëllimi i broshurës është prezantimi i modelit dhe strategjisë së rehabilitimit (shërbimeve) të bazuar në bashkësi (RBB) institucioneve të Kosovës dhe bashkësisë në përgjithësi, me qëllim të njohjes dhe përfshirjes së saj në të ardhmen si pjesë përbërëse e programeve të qeverisë për ofrimin e shërbimeve të duhura me qëllim të arritjes së përfshirjes së plotë të PAK në shoqëri.

Broshura zhvillohet në tre kapituj.

Në pjesën e parë të kapitullit të dytë paraqiten dokumentet e KB që kanë të bëjnë me çështjen e aftësisë së kufizuar.

Në pjesën e dytë të kapitullit të dytë paraqitet historiku i RBB-së dhe angazhimet e Kuvendit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe katër agjencive të saja në promovimin dhe implementimin e RBB-së në mbarë botën me qëllim të përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuar (PAK) në shoqëri.

Në pjesën e tretë të këtij kapitulli paraqitet korniza ligjore (dokumentet dhe iniciativat) për promovimin dhe zhvillimin e RBB-së në Kosovë.

Në fund të këtij kapitulli paraqitet historiku dhe zhvillimi i RBB-së në Kosovë që nga viti 1994 nga Shoqata e praplegjikëve dhe e paralizës së fëmijëve të Kosovës (SHPPFK) më vonë e riemëruar HandiKOS.

Në kapitullin e tretë paraqitet vizioni për të ardhmen dhe qasja multi-sektoriale e RBB-së, ashtu siç është propozuar nga Kuvendi i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara dhe katër agjencitë (OBSh, UNICEF, UNESCO dhe ILO) në dokumentin e përbashkët "RBB-ja për dhe me personat me aftësi të kufizuar".

Shpresojmë që kjo broshurë të jetë e dobishme sa i përket të kuptuarit e përpjekjeve që ka bërë Shoqata e paraplegjikëve dhe fëmijëve me paralizë të Kosovës, pas lufte e riemëruar si HandiKOS, në përkrahjen dhe mbështetjen e PAK-ve me shërbime, material ortopedik dhe mjekësor në një rën anë dhe në anën tjetër në promovimin e përfshirjes së tyre në shoqëri.

Në historinë e RBB-së, në botë, gjejmë shumë shembuj të implementimit të RBB-së nga OJQN-të si: Save the Children, Rehabilitation International, Handicap International si dhe agjencia UNICEF në bashkëpunim me autoritetet dhe OJQ-të lokale, por kjo ndodh në masë të vogël, në pak fusha dhe në periudha të shkurtra. Më pas këto organizata përpiqen që projektet e tyre t'ua dorëzojnë autoriteteve dhe punëtorëve lokal. Shumë nga këto projekte ndërpritën për shkak të mungesës së përkrahjes financiare nga agjencite ndërkombtare dhe gadishmrisë së qeverive lokale që këtë program ta adoptojn dhe mbështesin në të ardhmen.

RBB-ja si koncept i bazuar në të drejtat e njeriut i cili që nga viti 1995 implementohet nga HandiKOS-i në bashkëpunim dhe mbështetje nga agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare nuk mund të zgjasë përgjithmonë. Mu për shkak të largimit të këtyre organizatave nga Kosova ky program tani duhet të gjej përkrahjen e plotë nga Qeveria si qasje ndër ministrote duke përfshirë minimum tre fusha edhe atë të arsimit, shëndetësisë, punës dhe mirëqenies

I. HYRJE

sociale si dhe krijimin e njësisë për RBB në nivel të zyrës së kryeministrit gjegjësisht divizionin për çështjen e aftësisë së kufizuar. Në të kundërtën qytetarët me aftësi të kufizuar do të mbesin edhe pa këtë minimum të shërbimevetë bazuar në nevojat dhe interesat e tyre si dhe i tërë mundi i ndërtimit të strukturës, pajisjeve, stafit profesional do të shkatërrohen gjë e cila do të shkaktojë vazhdimin e përjashtimit dhe segregimit të qytetarëve me aftësi të kufizuar në Kosovë. Prandaj ne fuqimisht kërkojmë nga qeveria dhe institucionet e saja që sa më shpejtë të krijojë bazën legjislative si dhe mekanizmat për implementimin e mëtutjeshëm të këtyre shërbimeve të propozuara në kapitullin e fundit “vizioni për të ardhmën”.

7

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Skenari Ndërkombëtar për çështjen e AK

II. Shërbimet e rehabilitimit të bazuar në bashkësi

1. Skenari Ndërkombëtar për çështjen e AK

Dokumentet e KB

- Deklarata Universale mbi të drejtat e njeriut (UDHR) 1948
- Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtën ekonomike, sociale dhe kulturore (ICE-SCR) 1966
- Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike (ICCPR) 1966
- Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor (CEDR) 1965
- Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) 1979
- Konventa kundër torturës dhe mizorive të tjera, trajtimi ose dënimi johuman apo degradues (CAT) 1984; dhe

- Konventa mbi të drejtat e fëmijës (CRC) 1989

Përveç këtyre marrëveshjeve, Kuvendi i përgjithshëm i KB ka miratuar disa Rezoluta dhe deklarata që në mënyrë specifike trajtojnë çështjen e aftësisë së kufizuar, të cilat kanë kontribuar mjaft në ngritjen e vetëdijes mbi dimensionin e të drejtave të njeriut lidhur me çështjen së aftësisë së kufizuar si:

- Parimet për mbrojtjen e personave me sëmundje mendore dhe përmirësimi i kujdesit të shëndetit mendor .
- Programi botëror i aksionit lidhur me personat me aftësi të kufizuar (WPA);

- *Dhjetëvjeçari i Personave me aftësi të kufizuar të Kombeve të Bashkuara* (1983 1992) u shpall si periudhë fillestare për implementimin e programit botëror të aksionit i cili u miratua nga Kuvendi i përgjithshëm i Kombeve të bashkuara në vitin 1982 sipas rezolutës 37/52 të Kuvendit me objektivë themelore:

“promovimin e masave efektive për parandalimin e aftësisë së kufizuar, rehabilitimin dhe realizimin e qëllimeve për “pjesëmarrje të plotë” të personave me aftësi të kufizuar në jetën sociale si dhe zhvillimi i “barazisë”. Kjo nënkupton mundësi të barabarta me ato të tërë popullatës dhe pjesëmarrje të barabartë në përmirësimin e kushteve jetësore që rrjedhin nga zhvillimi social dhe ekonomik. Konceptet e këtilla në të gjitha vendet duhet aplikuar me shtrirje dhe intenzitet të njëjtë, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit të tyre”.

8

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Skenari Ndërkombëtar për çështjen e AK

- Kuvendi i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në rezolutën e tij 42/58, ftoi shtetet anëtare të kyçen në planet, projektet dhe strategjitë e tyre zhvillimore kombëtare me qëllim për t'u ndihmuar personave me aftësi të kufizuar dhe për të përfshirë projekte të tilla në programet shtetërore

- Takimi i grupit ekspert të Kombeve të Bashkuara, i cili konsideronte strategjinë afat gjatë për implementim të mëtejshëm të Programit botëror të aksionit që u mbajt në Vancouver, Kanadë, nga 25 – 29 prilli i vitit 1992, propozoi që “çështjet e aftësisë së kufizuar duhet integruar në aktivitetet e përgjithshme të organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare”.

- Rezoluta 47/88 Për Lehtësimin e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri e Kuvendit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara “Nxiti Qeverinë të angazhohet në përmirësimin e gjendjes së personave me aftësi të kufizuar, përmes adresimit të çështjeve të aftësisë së kufizuar në kuadër të politikave të integruara social-zhvillimore që lidhen me çështjet tjera social-ekonomike, me objektivë themelore: lehtësimin e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri” dhe aty ku është e mundur integrimin e komponentëve të aftësisë së kufizuar në programet e ndihmës teknike dhe bashkëpunimit teknik. Në po të njëjtën rezolutë, nga sekretari i përgjithshëm kërkohet që të “integrojë çështjen e aftësisë së kufizuar në shkallë më të gjerë dhe me prioritet më të lartë në politikat, programet dhe projektet e agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara.

- **Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar (Rezoluta 48/96 e Kuvendit të përgjithshëm të KB)**

Projektligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i cili formon bazën e Rregullave standarde të Kombeve të Bashkuara mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar deklaron se:

Parimet e të drejtave të barabarta nënkuptojnë se nevojat e çdo individi janë të një rëndësie të barabartë, se nevojat e tilla duhet të përbëjnë bazën e planifikimit të shoqërive dhe se duhet përdorur të gjitha burimet në mënyrë që të sigurohet se çdo individ ka mundësi të barabarta për pjesëmarrje.

Ky dokument është një udhëzues ndërkombëtar i cili shërben për formulimin e politikave kombëtare të aftësisë së kufizuar. Rregullat përmbajnë 22 parime të politikave të cilat mbulojnë sektorë të ndryshëm. Në kuadër të çdo parimi ekzistojnë opsione të ndryshme të politikave për mënyrën e implementimit të parimit.

Rregullat standarde ofrojnë strukturën bazë dhe udhëzimin për politikat gjithëpërfshirëse kombëtare mbi aftësinë e kufizuar. Rregullat më shumë theksojnë integrimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar në të gjitha politikat relevante se sa trajtimin e izoluar apo të veçantë të tyre.

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Skenari Ndërkombëtar për çështjen e AK

Kapitulli i I. PARAKUSHTET PËR PJESËMARRJE TË BARABARTË

- Rregulla 1. Ngritja e vetëdijes
- Rregulla 2. Kujdesi shëndetësor
- Rregulla 3. Rehabilitimi
- Rregulla 4. Shërbimet plotësuese

Kapitulli i II. – SFERAT SHËNJESTËR PËR PJESËMARRJE TË BARABARTË:

- Rregulla 5. Qasja
- Rregulla 6. Arsimimi
- Rregulla 7. Punësimi
- Rregulla 8. Të ardhurat dhe sigurimi social
- Rregulla 9. Jeta familjare dhe integriteti personal
- Rregulla 10. Kultura
- Rregulla 11. Rekreacioni dhe sporti
- Rregulla 12. Besimi (religjioni)

Kapitulli i III. – MASAT E IMPLEMENTIMIT

- Rregulla 13. Informimi dhe hulumtimi
- Rregulla 14. Hartimi i politikave dhe planifikimi
- Rregulla 15. Legjislacioni
- Rregulla 16. Politikat ekonomike
- Rregulla 17. Bashkërendimi i punës
- Rregulla 18. Organizatat e personave me aftësi të kufizuar
- Rregulla 19. Trajnimi i personelit
- Rregulla 20. Monitorimi dhe vlerësimi kombëtar i programeve të aftësisë së kufizuar
- Rregulla 21. Bashkëpunimi teknik dhe ekonomik
- Rregulla 22. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Kapitulli i IV. – MEKANIZMAT MONITORUES

Instrumentet tjera të Kombeve të Bashkuara të cilat adresojnë çështjen e aftësisë së kufizuar përfshijnë:

- Konventa e ILO-s 1958 (Nr. 111) lidhur me diskriminimin sa i përket punësimit dhe punës;
- Konventa e UNESCO-s 1962 kundër diskriminimit në arsim; dhe
- Konventa e ILO-s (nr.159) e vitit 1983 lidhur me Rehabilitimin profesional dhe punësimin (personat me aftësi të kufizuar).

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB në botë

2. RBB në botë

Dokumentet:

- Në vitin 1978, në Alma Ata, OBSH-ja organizoi një Konferencë ndërkombëtare mbi Kujdesin primar shëndetësor dhe propozoi që “Kujdesi primar shëndetësor” duhet të adresojë problemet kryesore shëndetësore në bashkësi dhe në këtë mënyrë përmes ofrimit të shërbimeve promovuese, parandaluese, kurative dhe rehabilituese promovon shëndetësinë për të gjithë. Në fund të Konferencës ata përpiluan deklaratën “*Shëndetësi për të gjithë në vitin 2000*”.
- Sipas deklaratës së lartpërmendur, OBSH-ja zhvilloi strategjinë e rehabilitimit të bazuar në bashkësi (RBB) si koncept për prfshirjen e RBB-së në sistemin shëndetësor dhe programet zhvillimore në nivel të bashkësisë.
- Doracaku i RBB-së *trajnimi për personat me aftësi të kufizuar në bashkësi*, (OBSH 1989) është draftuar në 1979 dhe shpjegon se si personat me aftësi të kufizuar, familjet dhe bashkësia e tyre mund të marrin përsipër rehabilitimin dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuar.
- Në vitin 1994, për menaxherët e programeve, OBSH-ja publikoi udhëzuesin “*Rehabilitimi i bazuar në bashkësi dhe shërbimet referuese të kujdesit shëndetësor*”, i cili fokusohet në rolin e sistemit të kujdesit shëndetësor në RBB-ë dhe në shërbimet referale të rehabilitimit.

Politikat dhe strategjitë për RBB-në

- Viti ndërkombëtar i personave me aftësi të kufizuar, 1982, vuri në lëvizje një proces drejt vetëdijesimit lidhur me problemet - dhe potencialet – e personave me aftësi të kufizuar.

Në kohën e përgatitjes së dhjetëvjeçarit thyerja e parë u bë përmes qasjes nga objekt i kujdesit në faktor të veprimit. Propozimi origjinal për të pasur Vit për personat me aftësi të kufizuar u zëvendësua me Vit të personave me aftësi të kufizuar. Kjo shënoi fillimin e qasjes revolucionare ndaj çështjes së aftësisë së kufizuar me vlerësimin se personat me aftësi të kufizuar janë para së gjithash njerëz të cilët kanë aftësi, vullnet dhe të drejtë të jenë faktorë aktiv dhe përgjegjës për jetët e tyre.

- Në vitin 1994, me qëllim të promovimit të qasjes së përbashkët për zhvillimin e programeve të RBB-së ILO, UNESCO, OBSH hartuan *Dokumentin e përbashkët mbi RBB-në*.
- Në vitin 2001 ILO, UNESCO, UNICEF dhe OBSH, hartuan dokumentin e ri të përbashkët: *Rehabilitimi i bazuar në bashkësi për dhe me personat me aftësi të kufizuar*.

“Qëllimi i këtij dokumenti është vazhdimi i promovimit dhe përkrahjes së RBB-së dhe objektive të saja si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të cilat janë të nevojshme për të arritur përfshirjen sociale dhe barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar. Ne gjithashtu dëshirojmë që për hartuesit e politikave dhe menaxherët e programeve të qartësoj-

11

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB në botë

më qasjet për implementimin e RBB-së, me qëllim të promovimit të pjesëmarrjes së shtuar të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit midis të gjitha shërbimeve qeveritare, joqeveritare dhe grupeve të cilat mund të kontribuojnë në implementimin e sukseshem të RBB-së”.

Në dokumentin e përbashkët gjejmë definicionin e RBB-së: “RBB-ja është strategji, në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të bashkësisë, për rehabilitim, barazim të mundësive dhe përfshirje sociale të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuar.

RBB-ja implementohet përmes përpjekjeve të kombinuara të vetë personave me aftësi të kufizuar, familjeve të tyre, bashkësive dhe shërbimeve përkatëse të shëndetësisë, arsimit, shërbimeve profesionale dhe sociale”.

“Objektiva kryesore e RBB-së është fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar për të rritur aftësitë e tyre fizike dhe mendore, qasjen në shërbimet e rregullta dhe në mundësi, si dhe aktivizimin e tyre duke ndikuar që ata të kontribuojnë në bashkësitë dhe shoqëritë e tyre. Pra RBB-ja promovon të drejtat e personave me aftësi të kufizuar përmes ndryshimeve brenda bashkësisë.

Evoluimi i koncepteve të RBB-së, që nga viti 1994 shton theksin mbi të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen në bashkësi.

Termi “gjithëpërfshirje” është bërë një term i zakonshëm lidhur me parapërgatitjet arsimore të cilat mirëpresin të gjithë fëmijët në shkollat e rregullta të bashkësisë apo në qendrat mesimore, përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuar. Parimi i “gjithëpërfshirjes” zbatohet gjithashtu edhe për shërbimet e shëndetësisë, ato profesionale, si dhe për kultura dhe bashkësi. Termi “bashkësi gjithëpërfshirëse” ka përparësi meqë përqendrohet në të gjithë qytetarët dhe në trajtimin e barabartë të tyre. Veç kësaj fuqizon faktin se duhet garantuar të drejtat e të gjithë njerëzve, përfshirë edhe të personave me aftësi të kufizuar.

Në dokumentin e përbashkët katër agjencitë e Kombeve të Bashkuara propozojnë planin për zhvillimin e RBB-së i cili në vijim do të prezantohet në pika të shkurtra:

*Pjesëmarrja e PAK

*Politikat kombëtare

*Menaxhimi i programit:

- Nga niveli kombëtar deri te ai regjional

- Në nivel të bashkësisë

*Përkrahje multi-sektoriale për bashkësinë

- Përkrahje nga sektori i shëndetësisë
- Përkrahje nga sektori i arsimit
- Përkrahje nga sektori i punës
- Përkrahje nga OPAK-ët
- Përkrahje nga OJQ-të
- Përkrahje nga sektorë tjerë

Për të pasur program të qëndrueshëm të RBB-së përmenden kërkesat në vijim:

1. Njohja e nevojës për programin e RBB-së i cili është i bazuar në qasjen e të drejtave të njeriut

12

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB në botë

2. Përfshirja e RBB-së në kuadër të qeverisë me alokim të burimeve duhura
3. Bashkëpunimi multi-sektorial, përfshirë bashkëpunimin me OPAK-ët dhe OJQ-të
4. Disponueshmëria e burimeve dhe përkrahjes së bashkësisë nga jashtë
5. Prania e punëtorëve të bashkësisë
6. Gatishmëria e bashkësisë të përgjigjet (reagojë) ndaj nevojave

- Në maj të vitit 2003 OBSH-ja në bashkëpunim me Organizatat e KB, OJQ-të dhe OPAK-ët organizuan “Konsultën ndërkombëtare për rishqyrtimin e rehabilitimit të bazuar në bashkësi (RBB-së)”.

Ata rishqyrtuan çështjet kyçe në vijim:

1. Përfshirja e bashkësisë dhe pronësia
2. Bashkëpunimi multi-sektorial
3. Roli i OPAK-ve
4. Përhapja e RBB-së

13

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Skenari Kombëtar

3. Skenari Kombëtar

Dokumentet mbi RBB-në:

*** Udhëzuesit e përkohshëm të politikave të shëndetësisë për Kosovë, plani gjashtë mujor i veprimit (korrik 1999)**

Në shtojcën III të këtij dokumenti qasja e RBB-së u propozua si “Strategji për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar fizike dhe mendore në Kosovë”.

Synimi; Ofrimi i shërbimeve të plota rehabilituese për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar fizike dhe mendore, duke filluar nga bashkësitë e tyre për të vazhduar përmes inkuadrimin specifik në sistemin e gjithmbarshëm edukativ e për të përfunduar përmes zhvillimit të institucioneve speciale ku përfshihen shërbimet e kujdesit aktual në Prishtinë, spitalet rajonale, përkujdesja në institucionet speciale, nëse është e nevojshme dhe shërbimet e bazuara në bashkësinë e e në ambientin shtëpiak.

Plani i veprimit

Qëllimi afat-gjatë është që të ofrohet kujdesi përkatës mjekësor, të barazohen mundësitë dhe të bëhet i mundur integrimi socio-ekonomik i personave me aftësi të kufizuar..

Niveli komunal

Rifillimi i ofrimit të rehabilitimit të bazuar në bashkësi

• Ofrimi i rehabilitimit të bazuar në bashkësi do të rifillojë dhe do të zhvillohet përmes “Bashkësisë së personave me aftësi të kufizuar të Kosovës” – HandiKOS (më përpara: Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës) me:

- Themelimin e 10 grupeve regjionale
- Themelimin e 10 qendrave rehabilituese të bashkësisë
- Themelimin e 16 grupeve komunale

Përmes këtij rrjeti, personave me aftësi të kufizuar do t’u sigurohen kujdesi dhe ndihma e domosdoshme. Plani i zbatimit përmban:

- * Identifikimin në vazhdimësi të personave me aftësi të kufizuar ;
- * Përkrahjen e përgjithshme për personat me aftësi të kufizuar, prindërit e tyre dhe anëtarët e familjeve të tyre përmes konsultimeve dhe grupeve përkrahëse ;
- * Furnizimin me mjete ortopedike dhe materiale specifike të personave me aftësi të kufizuar ;
- * Inkuadrimin e personave me aftësi të kufizuar në bashkësitë e tyre ;
- * Evitimin e barierrave arkitektonike ;
- * Ofrimin e terapive fizioterapeutike, të punës dhe psikosociale përmes qendrave të rehabilitimit të bashkësisë (Qendra demonstruese do të krijohet në regjionin e Pejës) dhe përmes vizitave në shtëpi.

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Skenari Kombëtar

Për rehabilitimin e bazuar në bashkësi, do të nevojiten këto burime njerëzore:

- 100 punëtorë që punojnë me persona me aftësi të kufizuar
- 10 fizioterapeutë të nivelit të lartë
- 20 teknikë të fizioterapisë
- 10 teknikë të terapisë së punës

*** Udhëzuesit e përkohshëm të politikave të shëndetësisë për Kosovë (gusht 2000)**

Në faqen 21 – 22 të këtij dokumenti gjejmë:

Parandalimin dhe rehabilitimin e aftësisë së kufizuar

Synimi: Ofrimi në vazhdimësi i shërbimeve gjithëpërfshirëse për parandalimin e aftësisë së kufizuar dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuar brenda bashkësive, institucioneve arsimore dhe përmes institucioneve të specializuara dhe spitaleve ekzistuese.

Programi gjithëpërfshirës, përfshirë këtu kujdesin primar, sekondar dhe atë publik për adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuar fizike, është parashikuar me komponentët në vijim:

- Një rrjet efektiv të rehabilitimit të bazuar në bashkësi që shfrytëzon organizatat lokale dhe ndërkombëtare
- Avansimet në trajnime dhe kushte për fizioterapeutët dhe profesionistët tjerë kyç në rehabilitim.
- Themelimin e qendrës kombëtare orto-protetike në Prishtinë.
- Shërbimet e kujdesit akut në gjashtë spitale dhe institucione tjera sipas nevojës.

Në Departamentin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, për çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar, do të jetë përgjegjës një teknik i lartë. Ky zyrtar do të bashkëpunojë me shoqërinë civile dhe organizatat e personave me aftësi të kufizuar, do të koordinojë shërbimet për personat me aftësi të kufizuar në sektorin e shëndetësisë, dhe do të jetë pjesë e çfarëdo komiteti qeveritar që është përgjegjës për qasjen multi-sektoriale ndaj çështjes së aftësisë së kufizuar. Parandalimi i aftësisë së kufizuar është një prioritet i lartë, përfshirë vetëdijesimin për minat, parandalimin e aksidentit, kujdesin para shtatzënisë dhe para lindjes si dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në Kosovë do të bëhen planet për përmirësimin e shërbimeve të fizioterapisë. Kjo do të përfshijë zhvillimin e shërbimeve të fizioterapisë sipas një grupi të udhëzimeve strikte të zhvilluara nga specialistë përkatës.

Trajnimi për aftësinë e kufizuar do të përfshihet në plan programin e shërbimeve elementare ambulatorie për të gjithë punëtorët e shëndetësisë. Do të definohen rrjetet referuese midis kujdesit primar, shërbimeve sociale dhe kujdesit të veçantë.

Qendrat e rehabilitimit të bazuar në bashkësi, tani dhjetë në numër, përfundimisht do të arrijë në vëmendjen dhe menaxhimin e Kuvendeve komunale. Këto qendra sidoqoftë do të mbajnë lidhjet e tyre të bashkësisë dhe bordet e menaxhimit të bashkësisë.

Pajisja mjekësore, përfshirë edhe pajisjen për personat me aftësi të kufizuar, do të jetë pjesë e programit të pajisjes me barna esenciale dhe programit me pajisje mjekësore. Pajisja mjekësore përfshirë pajisjet ortoprotetike, përfundimisht duhet të jenë pjesë e programit të furnizimit me barna esenciale.

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Skenari Kombëtar

Përshtatshmëria për personat me aftësi të kufizuar duhet të jetë synimi i të gjitha lehtësimeve shëndetësore. Duhet të bëhet korrigjimi i ligjeve në mënyrë që të gjitha ndërtesat e reja të kenë pjerrina apo mjete tjera të qasjes për personat me aftësi të kufizuar. Me kohë, kur burimet lejojnë këtë, ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuar në ndërtesat ekzistuese është prioritet.

Personat me aftësi të kufizuar nuk duhet automatikisht të çlirohen nga bashkë-pagesa për shërbime. Bashkë-pagesa për personat me aftësi të kufizuar duhet bërë në bazë të nevojës dhe mundësisë për të paguar.

*** Korniza gjithëpërfshirëse e politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar**

Në parathënien e dokumentit shkruan :

“UNIMK-u, në dhjetor të vitit 2000, në kuadër të administratës së vet formoi grupin punues (Task Force) mbi aftësinë e kufizuar, detyra kryesore e të cilit ka qenë të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë, e cila do të jetë në pajtim me Rregullat Standarde të KB për barazimin e mundësive të personave me aftësi të kufizuar. Strategjia mbi çështjen e aftësisë së kufizuar do të zgjerojë qasjen e çështjes së aftësisë së kufizuar duke u bazuar në aspektin e të drejtave e njeriut që është edhe njëri nga qëllimet e Kornizës Kushtetuese.

Grupi punues (Task Force) përbëhet nga përfaqësues të HandiKOS-it, grupeve të tjera të aftësisë së kufizuar, Handicap International, dhe përfaqësues të disa departamenteve të administratës së përkohshme të përbashkët. Zhvillimi i Kornizës gjithëpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë do të jetë një proces pjesëmarrës në të cilin do të përfshihen personat me aftësi të kufizuar, përkrahësit dhe aktorë të tjerë.

Qëllimi është që grupeve të aftësisë së kufizuar t'u ofrohet pjesëmarrje në planifikimin e politikës në mënyrë që nevojat e personave me aftësi të kufizuar të merren parasysh sa herë që të formulohet politika. Janë bërë propozime (që varet nga burimet në dispozicion) për krijimin e një Zyre mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në zyrën e Kryeministrit me qëllim të implementimit të Kornizës gjithëpërfshirëse të politikës mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në të gjitha nivelet e qeverisë së Kosovës. Po ashtu tentohet që grupi punues i cili funksionon në kuadër të UNMIK-ut të transformohet në Këshill mbi çështjen e aftësisë së kufizuar, e cila do të shërbejë si strukturë konsultative, mendimdhënëse dhe mbikëqyrëse mbi çështjet e aftësisë së kufizuar.

Në pjesën E. *UDHËZUESIT POLITIKË- NJË HAP PARA mund të shohim:*
“E.4 Rehabilitimi i bazuar në bashkësi

Modeli social dhe i të drejtave të njeriut mbi çështjen e aftësisë së kufizuar propozon një rol më qendror për personat me aftësi të kufizuar në planifikimin, zhvillimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të rehabilitimit. Me fjalë të tjera, do të ketë një zhvendosje të pushtetit nga profesionistët te personat me aftësi të kufizuar. Kjo nënkupton ofrimin e shërbimeve përmes të cilave nevojat e personave me aftësi të kufizuar plotësohen plotësisht. Për këtë arsye, rehabilitimi i bazuar në bashkësi (RBB-ja) duhet të formojë bazën e strategjisë së rehabilitimit.

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Skenari Kombëtar

Objektiva e politikës është:

Ngritja e vetëdijes mbi RBB-në dhe krijimi i qasjes në shërbimet përkatëse të rehabilitimit të bazuara në qasjen e RBB përmes zhvillimit ekzistues të rrjetit të HandiKOS-it.

Strategjitë për rehabilitim përfshijnë:

Zhvillimin e plan-programit dhe trajnimin përkatës të punëtorëve të bashkësisë përfshirë këtu, terapinë primare, rehabilitimin angazhues psiko-social dhe parandalimin.

Zhvillimin e sistemit të decentralizuar të ofrimit të shërbimeve përmes përkrahjes së Qendrave të bashkësisë.

Bashkëpunimin ndër-sektorial dhe sistemin referues në nivelin lokal;

Sigurimi i mjeteve të përshtatshme dhe të mundshme ndihmëse;

Partneritetet midis personave me aftësi të kufizuar dhe profesionistëve të cilët adresojnë nevojat reale të personave me aftësi të kufizuar.

*** Ministria e shëndetësisë/Grupi punues i RBB-së**

Në vitin 2002, me kërkesën e HandiKOS-it që RBB-ja të bëhet pjesë e kujdesit shëndetësor primar dhe që në nivel të qeverisë duhet pasur komponent multisektoriale, zyrtarët e shërbimeve mjekësor në Ministrinë e shëndetësisë, krijuan grupin punues të përbërë nga: pjesëtarë nga Mjekësia fizikale dhe e rehabilitimit, njësi e Ministrisë së shëndetësisë, HandiKOS-i, Shëndeti mendor, grup ky i cili analizoi situatën dhe paraqiti një draft plan.

Për këtë qëllim u mbajtën disa takime.

Drafti i parë u prezantua në shkurt 2004 dhe u diskutua në grupin punues i cili dha disa propozime për përpunimin e “draft planit të dytë për integrimin e rehabilitimit të bazuar në bashkësi në kujdesin primar shëndetësor në Kosovë”.

Ky plan u përpunua nga njësia për mjekësi fizikale dhe rehabilitim në kuadër të Ministrisë së shëndetësisë, bazuar në rezultatet nga diskutimet e mbajtura në grupin punues për rehabilitimin e bazuar në bashkësi dhe rekomandimet e OBSH-së.

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Legjislacioni aktual me influencë në RBB

4. Legjislacioni aktual me influencë në RBB

- Në kuadër të prezentimit të dispozitave të ligjeve në Kosovë të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me PAK-ët ligjeve në fjalë u shtohet rregulla standarde përkatëse (pjesa e hijezuar) me qëllim të fuqizimit të ligjit në fjalë.

Ligji Nr 2004/3 Kundër Diskriminimit

Neni 2 Parimet

Rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin mbështetet në këto parime:

- a) Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes marte- sore, gjuhës, aftësisë së kufizuar fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera;
- b) Parimin e përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe të të gjithë anëtarëve të komuniteteve lidhur me punësim në kuadër të organeve publike në të gjitha nivelet.

Neni 3 Termet

Për qëllimet e nenit 2.a, termet në vijim kanë këto kuptime:

- a) Diskriminimi i drejtpërdrejtë nënkuptohet kur një person trajtohet, është trajtuar, ose do të trajtohet në mënyrë të pabarabartë në krahasim me tjetrin, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e përshkruara nën 2 a;
- b) Ngacmimi konsiderohet diskriminim, brenda kuptimit të nenit 2 a, kur një sjellje kundër dëshirës (që përfshin por nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike) dhe që bazohet në një apo më shumë nga bazat e përshkruara nën nenin 2 a, e cila ka për qëllim apo ndikim në shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues dhe fyes, si është përcaktuar nga ai person;

Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar

Rregulla 15. Legjislacioni

Shtetet kanë përgjegjësi për të krijuar baza legale të masave për të arritur objektivat për pjesëmarrje të plotë dhe barazi për personat me aftësi të kufizuar.

***Ligji Nr 2004/4 për shëndetësinë**

Kapitulli VI Organizimi dhe implementimi i kujdesit shëndetësor:

Neni 26: Kujdesi shëndetësor i qytetarëve sigurohet në kuadër të sistemit unik, të integruar të veprimtarisë shëndetësore, nëpërmjet të zbatimit të masave parandaluese, mjekuese, shëruese dhe rehabilituese shëndetësore.

Neni 28 Kujdesi parësor shëndetësor.

Neni 28.1: Komunat janë përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor si dhe përcjelljen e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin të tyre.

28.4: Kujdesi parësor shëndetësor përfshin:

- a) Përparimin, parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe dëmtimeve;
- f) Kujdesin për shëndetin mendor të bazuar në bashkësi
- g) Rehabilitimin e bazuar në bashkësi

Ligji Nr. 2004/38 Për te drejtat dhe përgjegjësit e qytetareve ne kujdesin shëndetësor

Neni 4 E drejta në kujdes cilësor shëndetësor

4.5.1.1.1 Ofrimi i shërbimeve është pa asnjë diskriminim, atëherë kur gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore qytetarët nuk janë të diskriminuar në bazë të pozitës së tyre shoqërore, pikëpamjeve politike, prejardhjes, kombësisë, kualifikimit ose mbi çfarëdo baze tjetër, e cila nuk është e lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore.

Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar

Rregulla 2. Kujdesi shëndetësor

Shtetet duhet të sigurojnë kushtet për një përkujdesje efektive shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar.

Rregulla 3. Rehabilitimi

Rehabilitimi është një koncept fundamental sa i përket aftësisë së kufizuar. Shtetet duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimeve rehabilituese personave me aftësi të kufizuar në mënyrë që ata të arrijnë dhe mbajnë një nivel optimal të pavarësisë dhe funksionalitetit.

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Legjislacioni aktual me influencë në RBB

• **Ligji Nr. 2002/2 mbi arsimin primar dhe sekondar, i miratuar me 26 shtator 2002.**

Kapitulli I

Neni 3: E drejta për arsim:

3.1 Është detyra e përgjithshme e MASHT-it që, në bazë të dispozitave të këtij Ligji dhe ligjit përkatës, të nxit arsimimin e njerëzve në Kosovë dhe të kanë një program të përshtatshëm dhe të efektshëm të arsimit fillor dhe të mesëm, të pranueshëm për të gjithë.

Kapitulli II Organizimi i arsimit fillor dhe të mesëm

Neni 5 Jodiskriminimi

5.1 Regjistrimi dhe përparimi në të gjitha nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, mundësohet pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë për arsye reale apo të supozuara që kanë lidhje me gjininë, racën, prirjen seksuale, dëmtimet fizike, intelektuale ose dëmtime tjera, gjendjen civile, ngjyrën, religjionin, opinionet politike apo të tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti kombëtar, pronësinë, vendlindjen apo rrethanat e tjera të nxënësit ose familjes së tij.

Kapitulli III

Neni 15 Funksione të tjera të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë

15.1 MASHT harton politikën dhe protokolle për arsimimin e personave me nevoja speciale, dhe në veçanti

a) Ndhmon komunat nëpërmjet financimeve shtesë ose me mjete të tjera, në mënyrë që ato të përmbushin detyrimet e tyre ndaj personave me aftësi të kufizuar apo personave tjerë që kanë nevojë nga dispozita për arsim special;

b) Merr masat për përgatitjen e teksteve shkollore dhe mjeteve të tjera arsimore të nevojshme për arsimin special;

c) Nxjerr udhëzime për arsimin special;

15.2 MASHT merr masa të posaçme për arsimimin e personave në burgje ose në institucionet e të burgosurve në moshë të re, si dhe për personat e mbyllur në institucione psikiatrike ose që janë të shtruar në spital për një kohë të gjatë;

Kapitulli IV: Përgjegjësitë e komunave

Neni 22 Transporti i nxënësve dhe mësimdhënësve

22.1 Komuna organizon transport të sigurt dhe të efektshëm për nxënësit që e ndjekin shkollimin e arsimit të detyrueshëm. Ajo mund të vendosë, dhe sipas dëshirës, të bëjë përjashtime për pagesa lidhur me koston e plotë ekonomike të transportit shkollor për:

a) Nxënësit që jetojnë brenda zonës së mbulimit, por brenda distancës prej (4) kilometrash nga shkolla, me përjashtim të nxënësve me aftësi të kufizuar.

Kapitulli VII Nevojat speciale

Neni 35	E drejta për arsim special
Neni 36	Procedurat administrative për vendimet mbi arsimin special
Neni 37	Vlerësimi profesional
Neni 38	Përmbajtja e mësimdhënies
Neni 39	Shërbimi këshillimor dhe shëndetësor për nevojat speciale
Neni 40	Mësimdhënia në gjuhën e shenjave dhe sistemin Braille

Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar

Rregulla 6. Arsimimi

Shtetet duhet të kenë parasysh parimet dhe mundësitë e arsimit të barabartë primar, sekondar dhe tretar për fëmijë, të rinj dhe të rritur me aftësi të kufizuar, në masat integruese. Ata duhet të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuar janë pjesë integrale e sistemit arsimor.

- **Ligji për Ndërtimin Nr 2004/15 e datës 27 maj 2004**

Neni 31 Kontrolli i projektit

31.1 Varësisht nga karakteristikat e ndërtimit, kontrolli i projektit vërteton qëndrueshmërinë mekanike dhe stabilitetin e objektit, izolimin zanor dhe izolimin nga temperatura, sigurinë nga zjarri, masat për kursimin e energjisë, kërkesat lidhur me shëndetin dhe mje-disin, eliminimin e pengesave për qasje për personat me aftësi të kufizuar fizike.

Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar

Rregulla 5. Qasje

Shtetet duhet të marrin parasysh rëndësinë e përgjithshme të qasjes në procesin e mundësisë së barazimit në të gjitha sferat e shoqërisë. Për personat me aftësi të kufizuar të të gjithallojeve, shtetet duhet (a) të paraqesin programe të veprimit që rrethi fizik të ketë qasje; dhe (b) të marrë masa për të siguruar qasje në informata dhe komunikime.

• **Ligji Nr 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë**

Neni 2.3 "Pension i aftësisë së kufizuar" nënkupton çdo pagesë të sigurisë sociale që u bëhet personave të cilët konsiderohen me aftësi të kufizuar sipas legjislacionit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i cili drejton skemën e tillë të pagesave.

Neni 2.7 "Person i /e varur" përkufizohet si individ i cili i takon njërit prej grupeve që vijojnë:

i. Personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuar që e bëjnë atë të paaftë për të punuar për punëshpërblyese;

ii. Personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar;

iii. Kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi përherë të kufizuar apo të personave në moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeç;

iv. Personat deri në moshën katëmbëdhjetë (14) vjeç;

v. Personat ndërmjet moshave pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë (18) dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm;

2.9. Një person do të konsiderohet se është me të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuar nëse është mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe nën moshën 65 vjeç dhe është me aftësi të kufizuar fizike apo mendore dhe është i paaftë për punë shpërblyese. Aftësia përherë e kufizuar dhe e meta e rëndë fizike dhe mendore përkufizohet aftësi përherë e kufizuar fizike dhe mendore në shkallë jo më pak se 80 %, siç është aftësia e kufizuar që e bën personin të paaftë për punë në kohën kur ai paraqet kërkesën dhe përnjë periudhë vijuese prej jo më pak se dy vite.

6.2 Familjet që paraqesin kërkesat e tyre në bazë të një anëtarit apo më shumë anëtarëve me aftësi përherë të kufizuar, duhet të paraqesin edhe certifikatën ekomisionit mjekësor për gjendjen shëndetësore të tyre. Procedura për konstatimin e shkallës dhe llojit të aftësisë së kufizuar nga komisioni mjekësor përcaktohet me Udhëzim të cilin e lëshon Ministria.

• **Ligji Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar**

Neni 1. Përkufizimet

1.3 "Pension i aftësisë së kufizuar" nënkupton një beneficium që administrohet nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm "Ministria") për t'u ofruar mbështetje financiare personave të rritur të cilët janë me banim të përhershëm në Kosovë dhe të cilët janë plotësisht dhe përherë me aftësi të kufizuar dhe të paaftë për çfarëdo lloji të punës.

Neni 2 Pensionet e aftësisë së kufizuar

2.1 Pensionet e aftësisë së kufizuar do t'u ofrojnë mbështetje financiare personave të përzgjedhshëm në përputhje me kriteret e parashtruara në këtë ligj dhe sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

2.2 Ministria formon Komisionin Mjekësor për të përcaktuar përzgjedhshmërinë mjekësore për pensionet e aftësisë së kufizuar.

Neni 3. Kriteret për përcaktimin e aftësisë së kufizuar

3.4 Personat të aftë për punësim apo që aktualisht janë të punësuar në çfarëdo mënyre duke përfshirë çfarëdo lloji vetëpunësimi, siç përkufizohet në ligjet tatimore të Kosovës, nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionin e aftësisë së kufizuar. Punësimi aktual, duke përfshirë edhe vetëpunësimin, nënkupton dëshminë e supozuar të aftësisë për punë. Përzgjedhshmëria për pensionin e aftësisë së kufizuar do të pushojë që në ditën e parë të punësimit ose vetëpunësimit.

3.5 Personat që marrin pensione themelore ose ndonjë beneficion me skemën e “Beneficionet për invalidët e luftës dhe të afërmit e atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë” nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionin e aftësisë së kufizuar.

3.6 Personat që janë të përfshirë si anëtarë të familjes me qëllim të përcaktimit të shumës së pagesave të ndihmës sociale nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionet e aftësisë së kufizuar.

Neni 13. Beneficionet e personave me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar

13.1 Për personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar udhëtimi në trafikun urban bëhet falas, kurse në trafikun ndër-urban udhëtimi bëhet me 50% të vlerës së biletës.

13.2 Të gjitha mjetet e udhëtimit të qytetarëve urban dhe ndër-urban duhet të rezervojnë vende të veçanta për personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar.

13.3 Për personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar, bileta hyrëse për në manifestimet sportive, shfaqjet artistike, muze, etj. është 50% nga çmimi i biletës.

13.4 Në të gjitha objektet publike (aeroportet, stacionet e trenit, stadiumet, hotelet etj.) duhet të sigurohet qasja për lëvizje, qëndrim dhe shërbime për personat me aftësi të përherë dhe plotësisht të kufizuar.

13.5 Të gjitha ndërtimet e reja të objekteve që ndërtohen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të sigurojnë qasje dhe të ofrojnë mundësi përdorimi nga personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar.

13.6 Personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë (mjete lëvizëse dhe pajisjet e ndryshme ortopedike, dëgjimit apo të pamurit) duke përfshirë këtu edhe auto- vetura të përshtatura për përdorimin e tyre.

13.7 Për personat me aftësi përherë dhe plotësisht të kufizuar duhet të përcaktohen tarifat e reduktuara të konsumit të energjisë elektrike.

13.8 Për rastet e përmendura nën paragrafët 13.1 deri 13.7, Ministrinë kompetente do të nxjerrin dispozita përkatëse.

Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar

Rregulla 8. Të ardhurat dhe sigurimi social

Shtetet janë të përgjegjshme për ofrimin e sigurisë sociale dhe mirëmbajtjes së të ardhurave për personat me aftësi të kufizuar.

Rregulla 7. Punësimi

Shtetet duhet ti kenë parasysh principet se personat me aftësi të kufizuar duhet të aftësohen për të ushtruar të drejtat e tyre njerëzore, veçanërisht në fushën e punësimit. Në të dy rajonet atë Urban dhe Rural ata duhet të kenë mundësi për punësim produktiv dhe fitim prurës në tregun e punës.

• Rregullorja nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës

Neni 2 – Parimet udhëheqëse

-Paragrafi (e) Jodiskriminimi: nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, etnike apo sociale, lidhjes me ndonjë komunitet nacional, pronës, lindjes, paaftësisë fizike, statusit familjar, shtatzënisë, orientimit seksual apo moshës

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - 5. RBB

5. RBB-ja në Kosovë

a. HandiKOS-i - para luftës së vitit 1999

Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës është themeluar në vitin 1983. Objektiva kryesore e saj ishte "përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuar në Kosovë" përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit.

Që nga viti 1989, gjendja e personave me aftësi të kufizuar u keqësua me të shpejtë, gjendje të cilën e ndihmoi kriza në kontekstin politik, social dhe ekonomik. Shkatërrimi i sistemit të kujdesit shëndetësor, humbja e vendeve të punës më së shumti preku këtë grup njerëzish të cilët edhe ashtu ishin plotësisht të varur nga burimet e pakta të familjes. Një pjesë e madhe e personave me aftësi të kufizuar jetonin me pak apo pa fare ndihmë nga shërbimet e mbrojtjes sociale, ngaqë me largimin e mbajtësve të familjes nga vendet e punës humbnin edhe ato pak të drejta që kishin gëzuar deri atëherë. Kjo gjë i bëri ata plotësisht të varur nga ndihma humanitare. Situata e këtillë shtyri shoqatën që të ndër marrë aksione me qëllim të zbutjes së situatës së PAK duke lobuar dhe avokuar tek institucionet e sistemit paralel për të indorpuar nevojat e PAK-ve në lëvizjen e gjithmbarshme popullore.

Programi i RBB-së filloi në gjysmën e parë të vitit 1994. Gjatë këtij viti shoqata me ndihmën e OJQ-ve ndërkombëtare, veçanërisht të Handicap International e cila paraqet edhe kontaktin e parë të shoqatës me një organizatë ndërkombëtare, me ç'rast u siguruan materiale si: karroca dhe material higjienik për 200 familje.

Ky program më tej vazhdoi të realizohet në bashkëpunim dhe bashkëveprim me HI dhe me organizata të tjera ndërkombëtare dhe lokale si:

- HANDICAP INTERNATIONAL, organizatë ndërkombëtare, përmes përkrahjes me kuadër nga jashtë (fizioterapeutit dhe psikologut) dhe ofrimit të pajisjeve ortopedike, mjekësore si dhe lojërave për edukim.

- NËNA TEREZË, shoqatë lokale humanitare/bëmirese, përmes kontributit të drejtpërdrejtë të mjekëve dhe infermierëve vullnetarë të kësaj shoqate.

- OXFAM-i, organizatë nga Britania e Madhe, përmes trajnimeve mbi të drejtat dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar në shoqëri si dhe ndihmave në veshmbathje, mjete higjienike, etj.

- Organizata dhe agjenci të tjera si Save the Children, Mercy Corps, etj, përmes sigurimit të pakove higjienike për rastet sociale dhe personave me aftësi të kufizuar që jetonin në kushte të vështira.

Gjatë kësaj kohe mbi 320 aktivistë të profileve të ndryshme përfshirë këtu edhe vet PAK u përfshinë në identifikimin, vlerësimin dhe përkrahjen e nevojave të PAK-ve. Ky grup aktivistësh paraqiste një bazë të mirë për krijimin e strukturave të para organizative të emërtuara grupe aktive lokale (GAL).

Programi është organizuar në hapa të ndryshëm:

1. Themelimi i grupeve aktive lokale në nivel komunal

- Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës morri përsipër të përcjellë dhe përforcojë programin e saj për identifikimin dhe ofrimin e ndihmës PAK-ve, përmes zhvi-

25

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB-ja në Kosovë

llimit të rrjetit të grupeve aktive lokale, në bashkëpunimin me Shoqatën “Nëna Terezë” dhe rrjetin e saj të ambulancave të kujdesit primar shëndetësor në Kosovë. Këto grupe aktive lokale (25) morën përsipër të sigurojnë kujdesin dhe përcjelljen e personave me aftësi të kufizuar (parandalimin e deformiteteve, varrëve dekubitare për shkak të palëvizshmërisë së tyre, luftimin e problemit të inkontinencës, parandalimin e infeksioneve urinare si dhe arritjen një niveli të kënaqshëm të pavarësisë me ndihmesat lëvizëse).

Përbërja e grupit aktiv lokal

1. mjeku
2. aktivisti për punë në terren
3. personi me aftësi të kufizuar

Detyrat e Grupeve aktive lokale

- Identifikimi, vizita, vlerësimi i nevojave dhe caktimi i prioriteteve

Grupet, pas identifikimit të PAK në komunat e tyre, me ndihmën e mjekut, plotësonin pyetësorët me informatat për aftësinë e kufizuar (diagnozën, statusin social, gjendjen shëndetësore) dhe eventualisht llojin e nevojave.

Me qëllim të caktimit të prioriteteve dhe procedurave të asistencës grupet këmbenin informatat me zyrën në Prishtinë dhe më pas shoqata grumbulloi informata për popullatën me aftësi të kufizuar në Kosovë në një bazë të kompjuterizuar të dhënash. Deri në këtë kohë ka pasur të regjistruar 2,900 PAK.

- Furnizimi me pajisje të duhura për përmirësimin e jetës sociale

Shoqata synonte përmirësimin e gjendjes sociale të PAK përmes sigurimit të mjeteve të cilat mundësojnë arritjen e nivelit të kënaqshëm të lëvizshmërisë dhe të një higjienie më të mirë. Prandaj, shpërndarja e materialit mjekësor, pajisjeve ortopedike (karrocave, patericave) dhe materialit higjienik ka funksionuar si në vijim:

- Shpërndarjen e drejtpërdrejtë në familje dhe edukimi rreth përdorimit dhe mirëmbajtjes së materialit.

- Vizitat përcjellëse, të realizuara nga zyrat lokale dhe ekipi i rehabilitimit (shërbimeve) të bazuar në bashkësi i nivelit qendror.

- Parandalimi i komplikimeve

Duke ndjekur po të njëjtën procedurë si atë që u përshkrua më lart (ndihma, vizitat e drejtpërdrejta), shoqata siguronte pajisje mjekësore duke iu përgjigjur në këtë mënyrë nevojave specifike të personave – me aftësi të kufizuar (inkontinenca, varët dekubitare, infeksionet urinare).

Ky aksion është bazuar në bashkëpunimin me strukturat ekzistuese shëndetësore (Shoqatën humanitare Nëna Terezë, spitalet shtetërore, dhe mjekët privat) për zhvillimin e njësive të kujdesit për PAK.

2. Qendrat e rehabilitimit në bashkësi

Në bazë të vlerësimeve të PAK-ve nga GAL-et u shfaq nevoja për themelimin e qendrave të rehabilitimit të bazuar në bashkësi dhe trajnimin e stafit të angazhuar në to. Këto qendra ofronin shërbime rehabilituese fizikale dhe psiko motorike kryesisht për fëmijë me patologji të ndryshme. Përveç kësaj qendrat në fjalë shërbenin edhe si vend për trajnimin e personelit, PAK-ve, pjesëtarët e familjes, organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive, rekreative, shoqërim të PAK-ve, etj.

26

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB-ja në Kosovë

b. - HandiKOS-i gjatë luftës

Në vitin 98 kur situata eskaloi në luftë të hapur dhe kur filloi zhvendosja e popullatës nga pjesët e përfshira në luftë, HandiKOS-i filloi të përshtatë aktivitetet e tij drej ofrimit të mundësisë për evakuim dhe vendosje në pjesët më të sigurta të Kosovës. Në këtë drejtim kemi pasur bashkëpunim të mirë me Këshillat e Emergjencës të cilët funksiononin në tërë Kosovën në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të përfshihen në programet për personat e zhvendosur.

Pasi që lufta përfshiu tërë Kosovën në fillim të vitit 99, kur filloi ekzodi drejt shteteve fqinje si Maqedonia, Shqipëria dhe Mali i Zi, u krijua një situatë dramatike për shak se nuk ishte e mundur të mbahet kontakti me familjarët e personave me aftësi të kufizuar, nuk kishte asnjë formë të informimit mbi rrjedhat e luftës dhe udhëzime për formën e veprimit dhe organizimit të qytetarëve për evakuim-zhvendosje. Si pasojë e kësaj situatë shumë persona me aftësi të kufizuar mbeten nën perkujdsjen familjare e cila ishte edhe më shumë e rrezikuar për shak të mungesës së tarnsportit për anëtarët me aftësi të kufizuar.

Megjithatë disa nga aktivistët e mbetur në Kosovë të shoqatës, në regjione të ndryshme të Kosovës vazhduan të mbanin kontaktet me PAK-ët dhe familjarët e tyre me qëllim të ofrimit të kujdesit të nevojshëm mjekësor dhe furnizimit me materiale mjekësore, mjete higjienike, sanitare, ushqim dhe veshmbathje.

Gjatë kohës së qëndrimit në Kampet e Refugjateve në Shqipëri dhe Maqedoni aktivistët e HandiKOS-it dhe Nënës Tereze filluan të organizojnë përkrahje për personat me aftësi të kufizuar si refugjatë e në bashkëpunim me UNHCR-në, Oxfamin, HI, Nënë Terezë e disa agjenci nderkombëtare duke ju ofruar shërbime në Kampe, informata për mundësitë e transferit në shtetet e treta si dhe pajisjet e domosdoshme sanitare dhe mjekësore.

Vlen të përmendet se në Kampet e Maqedonisë në bashkëpunim me HI, Oxfam, UNHCR, Kinderberg filluam të organizojmë edhe Qendrat e Rehabilitimit të bazuar në Bashkësi etj.

c. – HandiKOS-i pas luftës së vitit 1999

Pas luftës Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës u regjistrua në UNMIK si OJQ me emrin HandiKOS.

Faza e emergjencës fillon menjëherë pas kthimit të refugjateve nga shtetet e vendosura në kushte mjaft të rrezikshme ku nuk kishte infrastrukturë, rrymë, ujë, furnizim me ushqim, shërbime shëndetësore, shtëpitë të rrënuara/djegura, me rreziqe të mëdha nga fushat e minuara etj. Gjatë luftës u shkatërruan shumë zyra (grupe aktive lokale). Materialet dhe dokumentet u humbën dhe/apo u dogjën. Punëtorët vullnetarë braktisën vendin dhe jo të gjithë nga ata u kthyen sërish. Nga ata të cilët u kthyen shumica prej tyre iu kthyen profesionit ndërsa të tjerët gjetën punë me pagë në OJQ dhe agjenci ndërkombëtare.

HandiKOS-i prap filloi një organizim të ri duke u përpjekur që ta reaktivizonte rrjetin dhe të caktojte objektivat kryesore të veprimit kuptohet gjithnjë në bashkëpunim me OJQ-të vendore dhe agjencitë ndërkombëtare e me qëllim të përkrahjes së PAK dhe familjarëve të tyre me material dhe mjete të domosdoshme për jetë.

Në Kosovë arritën shumë OJQ ndërkombëtare dhe Agjenci humanitare. Kjo HandiKOS-it i ofroi mundësinë që të bëjë shumë shpejt rikonstruktimin e rrjetit dhe jo vetëm që rriti numrin e grupeve aktive lokale dhe të qendrave të bashkësisë por me ndihmën e përkrahjes nga jashtë i punësoi shumë nga vullnetarët. Punëtorët e rinj ishin zgjedhur në bazë të edukimit sekondar mjekësor. Në periudhën e emergjencës, për t'ia dalë mbanë me regjistrimin e PAK dhe shpërndarjen e materialit higjienik, mjekësor dhe ortopedik, për çdo grup aktiv lokal ishin të nevojshëm tre punëtorë ku dy prej tyre ishin punëtorë të terrenit dhe një përgjegjës i zyrës.

27


II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - Legjislacioni aktual me influencë në RBB

Në çdo qendër të bashkësisë ishin: koordinatori, dy punëtorë të rehabilitimit primar fizikal, një për aktivitetet psiko-motorike dhe një vozitës për transportimin e fëmijëve. Puna e qendrave të HandiKOS-it përcillej nga fizioterapeuti i lartë dhe Trajneri i aktiviteteve psiko-motorike të dy nga HI. Siç mund të shohim në tabelë, rrjeti i HandiKOS-it përbëhet nga 25 Zyra lokale dhe 12 Qendra të bashkësisë në shtatë degë të organizuara në pesë regjionet në vijim:

Rregulla 18. Organizata e personave me aftësi të kufizuar

Shtetet duhet të kenë parasysh të drejtat e organizatave për persona me aftësi të kufizuar për të përfaqësuar ata në nivel kombëtar, regjional dhe lokal. Shtetet duhet po ashtu ta kenë parasysh rolin këshillues të organizatave për persona me aftësi të kufizuar në vendet vendim-marrëse mbi çështjet e aftësisë së kufizuar

RRJETI ORGANIZATIV



PRISHTINË	<u>Katër qendra të bashkësisë:</u> Prishtinë, Drenas, Podujevë, Malishevë <u>Shtatë zyra lokale:</u> Prishtinë, Lypjan, Obiliq, Fushë Kosovë, Podujevë, Drenas
PEJË	<u>Një qender e bashkësisë:</u> Pejë <u>Kater zyra lokale:</u> Pejë, Deçan, Klinë, Istog
PRIZREN	<u>Dy qendra të bashkësisë:</u> Prizren, Therandë <u>Tre zyra lokale:</u> Prizren, Dragash, Therandë
GJILAN	<u>Një qender e bashkësisë:</u> Gjilan <u>Gjashtë zyra lokale:</u> Gjilan, Viti, Kamenicë,
MITROVICË	<u>Dy qendra të bashkësisë:</u> Mitrovicë dhe Vushtrri <u>Tre zyra lokale:</u> Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj Dhe <u>nenzyra</u> ne pjesen veriore te Mitrovices
GJAKOVË	<u>Një qender e bashkësisë:</u> Gjakovë <u>Dy zyra lokale:</u> Gjakove dhe Rahovec
FERIZAJ	<u>Një qender e bashkësisë:</u> ne Ferizaj <u>Tre zyra lokale:</u> Ferizaj, Kaçanik dhe Shtime

30

Kuadri (Personeli) aktual

Drejtoria:

Në nivel qëndror ekziston ekipi i RBB-së.

Objektivat e këtij ekipi janë:

- A.** Të përcjellë punën e punëtorëve të RBB-së në qendrat e komunitetit dhe zyrat lokale;
- B.** Të përmirësojë gjendjen (kushtet) e fëmijëve të cilët janë përfitues të shërbimeve në qendrat e komunitetit;
- C.** Të motivojë prindërit të jenë pjesë e procesit të rehabilitimit;
- D.** Të kyçet në zhvillimin e politikave të arsimit special dhe atij gjithëpërfshirës/inkluziv (klasave të bashkangjitura) në Kosovë dhe ti motivojë prindërit në këtë drejtim;
- E.** Të bëjë dhe mbajë regjistrin e përfituesve të shërbimeve të ofruara në qendrat e bashkësisë si dhe të krijojë statistika përkatëse;
- F.** Të bëjë ndërtimin e kapaciteteve të punëtorëve të RBB-së në të gjitha nivelet;
- G.** Të promovojë punën ekipore multidisiplinare të punëtorëve të RBB-së në të gjitha nivelet.

Detyrat e këtij ekipi janë si në vijim:

- 1.** Së bashku me punëtorët e RBB-së bën vlerësimin e parë dhe përgatit planin individual të veprimit për PAK;
- 2.** Mbikëqyr dhe e vlerëson punën e punëtorëve të RBB-së;
- 3.** Bën vlerësimin e fëmijëve në çdo 4 muaj nëpër Qendrat e bashkësisë;
- 4.** Siguron dhe ofron trajnime të vazhdueshme për punëtorët e RBB-së;
- 5.** Përpunon të dhënat e mbledhura nga rrjeti dhe krijon bazën e të dhënave (statistikave);

6. Sipas nevojës angazhohet në krijimin e partneritetit me institucionet e shërbimeve publike, në të gjitha nivelet.

Zyra lokale:

Në çdo komunë, zyra lokale ka nga 2 punëtorë.

Objektivat e punëtorëve të zyrës lokale janë:

- A. Tu sigurojë shërbime kualitative për personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre, të garantojë një ambient i cili përkrah/promovon mirëqenien dhe u mundëson personave me aftësi të kufizuar integrimin në shoqëri;

31

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB-ja në Kosovë

- B. Të marrë përsipër vlerësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre dhe të asistojë që të kenë qasje në shërbimet e duhura.

Detyrat:

1. Të mbrojë, përkrahë dhe promovojë mirëqenien e personave me aftësi të kufizuar duke :

- Organizuar takime me personat me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre për të identifikuar problemet si pasojë e aftësisë së kufizuar apo të natyrës tjetër dhe ndërmerr hapa konkrete për të minimizuar efektin e problemit apo referon në instanca tjera nëse problemi i kalon kompetencat e tij;
- Organizuar dhe koordinuar planin e aksionit për secilin person me aftësi të kufizuar, në komunën e tij, në bashkëpunim me ekipin e RBB-së nga drejtoria (vlerësimi i parë), vetë personin, kujdestarët, ekipet multidisiplinare të institucioneve publike (sipas nevojës), dhe organizatave/shoqatave të tjera të pavarura;
- Siguruar që ky plan i aksionit ti përgjigjet nevojave të personit me aftësi të kufizuar dhe familjes së tij;
- Këshilluar personat me aftësi të kufizuar për të drejtat e tyre dhe duke bërë lidhjen e tyre me burimet e mirëqenies.



Vizita shtëpiake - Mitrovicë

2. Të promovojë dhe monitorojë realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar;
3. Të promovojë mundësitë dhe qasjen e barabartë të personave me aftësi të kufizuar në shoqëri.
4. Të mbledhë dhe të disponojë me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuar (bazën e të dhënave) në lokalitetin që e mbulon;
5. Të zhvillojë bashkëpunimin ndër-organizativ duke punuar me organizatat brenda autoriteteve/publike dhe organizatat private apo vullnetare.

Për realizimin e detyrave të tyre ata ndjekin disa udhëzues si në vijim:

- * Formularin e regjistrimit, për grumbullimin e informatave mbi dëmtimet, gjendjen fizike, mendore, social-ekonomike, arsimimin, etj.
- *Librin e vizitave, që ndihmon ata të organizojnë punën e tyre.
- *Letrën referuese për kërkimin e shërbimeve
- *Planin e punës

32

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB-ja në Kosovë

Qendra e bashkësisë:

Në çdo qendër të bashkësisë zhvillohen rehabilitimi primar fizikal dhe stimulimi psiko-motorik. Për zhvillimin e rehabilitimit primar fizikal janë të angazhuar nga dy punëtorë për qendër dhe të gjithë këta kanë të mbaruar shkollën e mesme të mjekësisë, ku disa prej tyre janë teknik të fizioterapisë, deri sa për realizimin e stimulimit psiko-motorik, është i angazhuar nga një punëtorë për qendër.

Në Besjanë dhe Vushtrri për rehabilitimin primar fizikal është angazhuar vetëm nga një punëtor.

Për transportimin e fëmijëve çdo qendër e bashkësisë ka të punësuar nga një vozitës .

Detyrat e personelit të qendrës:

- Vlerësimi i çdo fëmije përmes kartelës vlerësuese;
- Përgatitja e planit të punës sipas nevojave të fëmijës në konsultim me trajnerin e rehabilitimit primar nga drejtoria e HandiKOS-it, e cila rregullisht viziton qendrat(dy herë në muaj);
- Përgatitja e listës së fëmijëve të cilët do të kontrollohen nga mjeku i HandiKOS-it;
- Rivlerësimi i fëmijëve çdo katër muaj pas ndjekjes së procesit të rehabilitimit.

Puna në qendër:

1. Rehabilitimi primar fizikal i realizuar nga dy punëtorë në çdo qendër përfshinë;

- Parandalimi i deformiteteve ortopedike përmes mobilizimit pasiv;
- Trajnimi për ruajtjen e baraspeshës;
- Pozita e drejtë gjatë qëndrimit ulur. Demonstrimi i përdorimit dhe përfitimet nga karrigeja me tavolinë në shtëpi me qëllim të parandalimit të deformiteteve si dhe promovimi i zhvillimit të fëmijës dhe pjesëmarrja e tij/saj në jetën familjare;
- Zvarritja dhe ecja duke përdorur paralelet dhe shëtitoret;
- Promovimi i aktiviteteve ditore, ushqimi, veshmbathja dhe higjiena personale;
- Këshillimi i prindërve që t'u mundësojnë fëmijëve të tyre t'i kryejnë këto aktivitete në shtëpi dhe të mos jenë tepër mbrojtës

2. Stimulimit psiko-motorik i realizuara nga një punëtor në çdo qendër përfshinë:

- Stimulimi mio-oral, për përmirësimin e ushqimit dhe të folurit;
- Aktivitetet lidhur me përmirësimin e komunikimit, përqendrimin, krijimtarisë së fëmijëve, veçmas për çdo fëmijë dhe në grup.

- Përgatitja e fëmijëve për t'u kyçur në sistemin e rregullt arsimor dhe motivimi i prindërve në këtë drejtim.
- Promovimi i shoqërizimit dhe aktiviteteve krijuese.

Perveç aktiviteteve të lartepërmendura punëtorët e rrjetit organizojnë edhe :

- * Takime me prindër ku diskutojnë për çështjet e Aftësisë së kufizuar duke përdorur materiale të ndryshme si broshura të ndryshme për aftësinë e kufizuar dhe rolin e famijareve në këtë proces
- * Takime me prindërit e fëmijëve me të njëjtën aftësi të kufizuar, për promovimin e këmbimit midis tyre të përvojave, sukseseve, dështimeve dhe pritjeve.



Aktivitetet grupore me prindër dhe fëmijë – Qendra e bashkësisë - Pejë

Ndërtimi i kapacitetit/trajnimet

Ndërtimi i kapacitetit të punëtorëve të RBB-së

a. Para luftës

Bazuar në faktin se punëtorët e angazhuar para luftës ishin në baza vullnetare dhe pa ndonjë përgatitje adekuatë për shërbimet e bazuara në bashkësi, HandiKOS-i ka organizuar mbajtjen e seminareve, trajnimeve dhe përpilimin e materialeve të ndryshme të cilat ndihmonin në ngritjen e kapacitetit të tyre me qëllim të realizimit me sukses të detyrave që ushtronin.

Seminaret

* 1-2 mars 1996, Prishtinë - seminari i organizuar nga Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës dhe Handicap International, me pjesëmarrjen e profesionistëve nga Handicap International, Oxfam-i dhe mjekëve lokalë. Në fund të secilit u përgatit një udhëzues pune për aktivistët e terrenit;

* nëntor, 1995 – seminari i organizuar nga Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës dhe Handicap International ku janë mësuar veprimet bazë të terapisë fizikale dhe përdorimit të pajisjeve dhe materialeve mjekësore të nevojshme;

*14 dhjetor 1996, - trajnimi mbi “Zhvillimin normal psiko-motorik të fëmijës” me fizioterapeutin nga H.I. Philippe Thiebault;

*mesi i vitit 1997 - sesioni trajnues mbi funksionimin e sistemit osteo-muskulor me fizioterapeutin nga H.I;

*30 tetor 1997 - sesioni trajnues mbi zhvendosjen e lindur të kërdhokullave;

*1997, sesione trajnuese të organizuara nga Oxfam-i, ku ndër më të rëndësishmet ishin:

- shtator 1997 – janar 1998: “Aftësia e kufizuar, barazia – trajnimi i trajnerëve”
- 12 - 20 dhjetor 1997 kursi “Prezantimi i krijimit (rritjes) së fondeve”
- Punëtorja për PAK “vetëdijesimi mbi të drejtat e njeriut”

Materialet e përdorura

- Udhëzuesi për nevojat e punëtorëve të terrenit
- Udhëzuesi për vizitat në familje dhe vlerësimin e gjendjes
- Format e vlerësimit dhe rivlerësimit
- Krijimi i bazës së të dhënave

34

II. SHËRBIMET E REHABILITIMIT TË BAZUARA NË BASHKËSI - RBB-ja në Kosovë

b. Pas luftës

Ndërtimi i kapacitetit të punëtorëve

Për ngritjen e kapaciteteve të kuadrove të qendrave të bashkësisë HandiKOS-i se bashku me Handicap International ka organizuar disa seminare si në vijim:

- shtator 1999 – seminari mbi paralizën cerebrale;
- janar 2000 – trajnimi mbi RBB-në dhe rolin e qendrës së bashkësisë (për kuadrin e grupit aktiv lokal dhe punëtorët e qendrave të bashkësisë);
- prill 2000 – sesioni trajnues mbi paralizën cerebrale;
- maj 2000 – sesioni trajnues mbi dëmtimin e palcës kurrizore dhe spina bifidën;
- shtator 2000 – seminari tre ditor mbi RBB;
- nëntor 2000 – sesioni trajnues mbi poliomielitin;
- shkurt 2002 – trajnimi dy ditor “Karroca” (këshilla dhe përdorimi: qëndrimi ulur dhe transferimet).

-korrik 1999, prill 2002 - **ICACBR** - Universiteti mbretëror i Kanadës (organizatë profesionale për zhvillim dhe ndërtim të kapacitetit të kuadrit për RBB0, u organizuan trajnim pesë javor në të cilat u përfshinë të gjithë punëtorët e HandiKOS-it. Programi përbëhej nga tre javë teori dhe dy javë praktikë e mbikëqyrur. Çdo pjesëmarrësi iu dha certifikatë dhe një doracak i cili në qendrat e RBB-së shërben si udhëzues shërben për implementimin e aktiviteteve të RBB- së si dhe udhëzues referues për institucionet e nivelit lokal.

- prill 2001 - mars 2002 - **Onlus Don Gnocchi** (Itali), i mbështetur nga Onlus R. Bazzoni gjithashtu nga Italia, bëri një vit trajnimi për 30 punëtorët e 10 qendrave të bashkësisë. Pjesa teorike u mbajt nga fiziatra dhe fiziatër – pediatri kurse pjesa praktike u mbajt dhe u mbikëqyr nga dy fizioterapeutë të lartë për një vit.

Ndërtimi i kapacitetit të grupeve të ndryshme të interesit

- gjatë vitit 2001- një fizioterapeut nga DSI-ja vizitoi personat me distrofi muskulore dhe po për të njëjtit dhe familjarët e tyre mbajti disa seminare.

- gjatë vitit 2001 me pjesëmarrjen e Programit finlandez për të drejtat e njeriut, HandiKOS-i organizoi seminare dhe punëtori në 10 komuna ndërsa gjatë vitit 2003 në 10 komuna tjera.

- gjatë vitit 2002 – 2003 HandiKOS-i në bashkëpunim dhe mbështetje nga FIDIDA ka organizuar program trajnues mbi Administrimin, të ndarë në katër module: Menaxhimi i ciklit të projektit, shkathtësitë e komunikimit, zhvillimi organizativ dhe shkathtësitë trajnuese.

- gjatë vitit 2003 – HandiKOS-i në mbështetje nga **UNICEF**-i ka publikuar pesë broshura që shërbejnë si udhëzues për prindërit e fëmijëve me paralizë cerebrale, sindromë Down, distrofi muskulore dhe spina bifida si dhe mbajtur tetë seminare për aftësi të kufizuara të ndryshme dhe të drejtat e fëmijëve.

- gjatë vitit 2003 – HandiKOS-i në mbështetje nga **Save the Children** ka organizuar punëtori për promovimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në vise rurale duke përfshirë evokimin lobimin në dhjetë komuna të Kosovës

Infrastruktura dhe pajisjet

Zyrat lokale

Zyra lokale në Suharekë, Malishevë, Rahovec, Lypjan dhe Dragash janë godina të reja; Zyra lokale e Istogut është riparuar; Zyrat tjera si ajo në F.Kosovë, Kastriot, Prishtinë, Podujevë, Drenas, Skenderaj, Mitrovicë, Vushtrri, Klinë, Deçan, Pejë, Prizren, Shtime, Kaçanik, Ferizaj, Gjakovë, Viti, Kamericë, Gjilan, janë të ofruara nga institucionet komunale; Të gjitha zyrat lokale kanë orëndi dhe janë të pajisura me kompjuter dhe mjete të tjera të punës.

Qendra e bashkësisë

Qendra e bashkësisë në Drenas dhe Pejë, janë godina të reja; Qendra e bashkësisë në Ferizaj është riparuar dhe zgjeruar ndërsa ajo në Prishtinë ekziston në Kuadër të Qendrës burimore; Qendrat tjera të bashkësisë si në Podujevë, Malishevë, Mitrovicë, Vushtrri, Suharekë, Prizren, Gjakovë, dhe Gjilan ndodhen në godina të ofruara nga institucionet komunale. Të gjitha qendrat e bashkësisë kanë pajisjen themelore për rehabilitim fizikal dhe stimulim psiko-motorik. Çdo qendër e bashkësisë gjithashtu disponon edhe një automjet për transportimin e fëmijëve



Qendra e bashkësisë - Therandë

Shënim: Disa zyra lokale dhe qendra janë në të njëjtën godinë. Këto janë në: Podujevë, Drenas, Vushtrri, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjakovë, dhe Gjilan.

Aktivitetet dhe të arriturat

- NË FUSHËN E ARSIMIT

- Inicimi dhe pjesëmarrja në hartimin dhe promovimin e kornizës në fushën e gjithëpërfshirjes në arsim;
- Pjesëmarrja në përgatitjen e ligjit për arsim primar dhe sekondar të Kosovës;
- Identifikimi i fëmijëve (gjatë viti 2003 i 258 fëmijëve) përmes vizitave shtëpiake dhe avokimi së bashku me familjarët për përfshirjen e tyre në sistemin arsimor;
- Parapërgatitja e fëmijëve në qendrat e bashkësisë për kyçe në sistemin arsimor duke u bazuar në konceptin e edukimit parashkollor;
- Ngritja e vetëdijes, edukimi dhe motivimi i prindërve mbi rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të tyre;
- Vlerësimi i vazhdueshëm i nivelit të implementimit të ligjit për arsim me kujdes të veçantë për kapitullin e shtatë “edukimi special” si dhe identifikimi i
- problemeve dhe pengesave me të cilat ballafaqohen fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre
- Zvogëlimi i analfabetizmit të PAK-ve përmes kurseve të shkrim leximit për të rinj, të rritur dhe sidomos për femra me aftësi të kufizuar



Çaste nga aktivitetet psikomotorike

- NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

- Identifikimi dhe vlerësimi i fëmijëve nga ekipi i RBB-së ku vetëm gjatë vitit 2004 në rehabilitimin fizikal dhe psiko-motorik janë përfshirë 674 me gjithsej 37 535 trajtime (shih shtojcën 2);
- Informimi dhe edukimi i prindërve/kujdestarëve të fëmijës mbi aftësinë e kufizuar, parandalimin e pasojave dhe aftësimin e fëmijës përmes:
 - pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në rehabilitimin primar fizikal dhe psiko motorik
 - seminareve të ndryshme
 - materialeve të përgatitura apo të përkthyer
- Informimi, edukimi i prindërve/kujdestarëve mbi shërbimet ekzistuese shëndetësore dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre (sistemi referues, Shih shtojcën 2);
- Identifikimi gjatë vitit 2003 i 86 dhe gjatë 2004 16 fëmijëve që mund të përfitojnë nga ndërhyrja kirurgjikale të cilët veç më janë referuar për shërbimet ortopedike në spitalin e Pejës. 41 prej tyre kanë ndërhyrje kirurgjikale dhe përmisim të dukshëm.
- Aftësimi i kujdestarëve përmes pjesëmarrjes aktive gjatë aktiviteteve në qendër si dhe udhëzimi për përshtatjen mjedisit shtëpiak me qëllim të eliminimit

pengesave si dhe pavarësimin të fëmijës për nevoja ditore personale (tavolinë me karrige, viti 2003 – 2004, 99 familje i kanë bërë ato);

- Krijimi i formës së vlerësimit të gjendjes dhe progresit të fëmijëve të përfshirë në procesin rehabilitues.

Për ngritjen e kapacitetit të punëtorëve të RBB-së, prindërve dhe PAK, HandiKOS-i ka (përgatitur/përkthyer) publikuar këto materiale:

- *“Fshatarët e vegjël me paaftësi”* David Werner
- Doracak për RBB-në nga ICACBR - Universiteti Mbretëror (Kanadë)
- Format e vlerësimit të Materiale trajnimi nga ekipi i Onlus Don Gnocchi, (Itali).
- *“Jeta pas dëmtimit të palcës kurrizore”* Shoqata e paraplegjikëve të Kanadës
- Përgatitjen dhe publikimin e fletëpalosjeve për motivimin e diagnostikimit të hershëm dhe trajtimin e zhvendosjes së lindur të kërdhokullave.
- Një komplet udhëzuesish:
 1. Paket në ndihmë të prindërve për mirërritjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar,
 2. Paraliza cerebrale,
 3. Sindromi Down,
 4. Distrofia muskulore dhe
 5. Spina bifida si pjesë e projektit “Përmirësimi i gjendjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike dhe gjinore” të mbështetur nga UNICEF-i.

- NË FUSHËN E KULTURËS DHE SPORTIT

Kultura

- Organizimi dhe mbajtja e koncerteve për shënimin e datave të rëndësishme për fëmijë dhe të rritur ku kanë marrë pjesë një numër i madh i PAK-ve;
- Organizimi i garimeve në poezi;
- Pjesëmarrja me rol në dramë “Jetë o jetë”,
- Organizimi i ekspozitave të artit figurativ me punime të fëmijëve me tre dhjetor, 1 qershorit dhe data të tjera të rëndësishme.;
- Aftësimi dhe përfshirja e grave me aftësi të kufizuar në aktivitetet e punëdores;
- Organizimi i pikniqeve dhe i ekskursioneve për fëmijë dhe femra me aftësi të kufizuar
- Organizimi i aktiviteteve “fëmija për fëmijën” në shkolla fillore me qëllim të vetëdijesimit të fëmijëve tjerë dhe mësimdhënësëve për aftësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuar;
- Përgatitja dhe publikimi i video-klipeve (“Dua të jetoj”, “Pa koment”, “Të drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuar”) këngëve si “ të jesh fëmijë ”, programeve dokumentare “Pozita e fëmijëve me aftësi të kufizuar”,
- Publikime të ndryshme për fëmijë si: “ Fjala ruhet kur shkruhet” , “ Njerëzit me Paaftësi – Të drejtat dhe përgjegjësitë për ne dhe për ju”, “Udhëtimi i gjatë, shumë i gjatë”, “Vigani i Zanës”.

Sporti

- Organizimi i sporteve të ndryshme si: pilot liga në basketboll, ping pong, atletikë, maratonë, shah, kampeve sportive etj;
- Organizimi i kampeve “aktive rehabilituese” për fëmijë dhe të rritur në Ulqin me gjithsej 450 pjesëmarrës me aftësi të kufizuara të ndryshme

- NË FUSHËN E MIRËQENIES SOCIALE

- Furnizimi me mjete orto-protetike (paterica, shëtitore, karroca, karroca tualeti etj) që nga viti 1994;
- Krijimi i bazës së të dhënave, statistikave të ndryshme që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuar;
- Referimi i personave me aftësi të kufizuar tek institucionet e mirëqenies sociale në komunat e tyre për shfrytëzimin e shërbimeve sociale dhe referimi i tyre për realizimin e të drejtave ligjore;
- Furnizimi me material mjekësor për trajtimin e plagëve dekubitare dhe inkotincës (katetër, qese urinatedhe kondom urinar);
- Furnizimi me materiale tjera si: veshmbathje, pako hixhienike, dhe mbulesa
- Lobimi dhe evokimi tek Ministria për krijimin e mundësive dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në trajnime profesionale ;
- Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për PAK lidhur programet fitimprurëse

39

- NË FUSHËN E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

- Shenjëzimi i vend parkimeve për PAK në ndërtesat publike në Prishtinë i realizuar në bashkëpunim me Handicap International dhe komunën e Prishtinës i përkrahur nga Agjencioni Evropian për rindërtim (EAR);
- Përgatitja e “Udhëzuesi për përshtatshmërinë e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuar”, të bazuar në standardet ndërkombëtare dhe ligjin e ndërtimit, mbështetur nga USAID dhe FDI-ja
- Ndërtimi i 96 pjerinave në objekte publike në tërë territorin e Kosovës të mbështetur nga EAR-i dhe OSBE-ja gjatë 2003
- Pjesëmarrja në hartimin e politikave të planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe urbanizmit;
- Pjesëmarrja në debatin për planifikim hapësinor të qytetit të Prishtinës

Analizat / hulumtimet rreth gjendjes së PAK-ve në Kosovë

- Baza e përgjithshme e të dhënave

Përmes punës së punëtorëve të 25 zyrave lokale HandiKOS-i deri në shtator 2004 ka të regjistruar 13 613 PAK. Nga ata 7451 janë meshkuj dhe 6028 femra. (shih shtojcën 1).

- Në vitin 2001 HandiKOS-i bëri vlerësimin e gjendjes / situatës së disa grupeve të personave me aftësi të njëjtën aftësi të kufizuar si: Sindromi Down, Spina Bifida, zhvendosja kongjenitale (e lindur) e kërdhokullave, dëmtimi i palcës kurrizore. Qëllimi i hulumtimit ishte arritja e një pasqyre më të qartë mbi moshën, arsimimin, trajtimin, gjendjen ekonomike dhe nevojat e tyre.

- FIDIDA (Agjencia ndërkombëtare zhvillimore e aftësisë së kufizuar e Finlandës) ka bërë hulumtimin “Analizë mbi pozitën e PAK në Kosovë”. E implementuar Në vitin 2002 nga agjencia “Gravir” aslb me Handicap International bënë “Analizën e gjendjes së PAK”. Në këtë analizë u intervistuan 391.

Qëllimi i hulumtimit ishte arritja e një pasqyre më të qartë mbi pozitën dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë. Ky hulumtim hedh në dritë pengesat kryesore me të cilat përballen në jetën e përditshme këta persona si dhe faktorët të cilat ua lehtësojnë sadopak jetën.

- Në vitin 2003 si pjesë e projektit me UNICEF-in u bë “Vlerësimi i gjendjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në Kosovë” ku u përfshinë 300 fëmijë. Vlerësimi në fjalë u bë në katër sfera: atë të arsimit, shëndetësisë, sociale dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

- HandiKOS-i me mbështetjen e Projektit Finlandez për të drejtat e njeriut formoi këshillin për avancimin e të drejtave të PAK-ve në Kosovë. Këshilli në fjalë në vitin 2001 bëri hulumtimin mbi njohjen, respektimin dhe shkeljen e të drejtave të PAK-ve në Kosovë ku u përfshinë 250 PAK. Ky raport u publikua me 3 dhjetor 2001.

III. Vizioni për të ardhmen**1. Rishqyrtimi i kapitullit të dytë të broshurës**

Para se të prezantohet propozimi i HandiKOS-it le të shqyrtojmë edhe një herë kapitullin e dytë të këtij materiali:

Në pjesën e parë të kapitullit të dytë prezantohet historiku dhe zhvillimi i RBB-së në botë. Me prezantimin e këtyre dokumenteve zyrtare dëshirojmë të japim informata mbi përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në shoqëri dhe krijimin e një “shoqërie për të gjithë”. Me siguri ka shumë çka për tu thënë rreth qindra programeve të RBB-së që janë krijuar në botë gjatë këtyre viteve nga OJQN, OJQ, OPAK, grupe religjioze, UNICEF-i, Save the Children dhe disa qeveri. Vlerësimi i programeve, pengesat

dhe dështimet, kanë qenë shkaku i ndryshimeve dhe zhvillimit gjatë 20 viteve, deri në takimin e fundit në Finlandë në maj 2003 për rishqyrtimin e RBB-së.

Në pjesën e dytë të kapitullit të dytë prezantohet:

Vullneti politik i autoriteteve të reja për përfshirjen e nevojave dhe të drejtave të PAK në legjislacion. Kjo është paraqitur qartë në udhëzimet e përkohshme të politikave të shëndetësisë për Kosovë (1999 dhe 2000) ku përmendet edhe rrjeti i HandiKOS-it.

Në përgatitjen e Kornizës gjithëpërfshirëse të politikave mbi çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë, të ligjit të arsimit dhe shëndetësisë si dhe ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanizëm, PAK-ët ishin të përfaqësuar nga HandiKOS-i.

Shqetësimi i autoriteteve për arsimin special për fëmijët me nevoja të veçanta është mjaft i qartë në ligjin për arsimin primar dhe sekondar.

Në pjesën e katërt të kapitullit të dytë prezantohet lexhislacioni me influencë në RBB.

Ligji i pensioneve për PAK është një dëshmi tjetër e qëndrimit pozitiv të autoriteteve tona drejt përfshirjes së PAK në shoqëri.

Në kuadër të Ligjit të shëndetësisë është përfshirë strategjia e RBB-së.

Kjo është arsyeja pse në këtë pjesë, HandiKOS-i jep propozimin e tij për implementimin e versionit të fundit të RBB-së të propozuar nga Kombet e Bashkuara dhe të prezantuar nga OBSH, UNESCO, UNICEF, dhe ILO në dokumentin e përbashkët "RBB-ja për dhe me personat me aftësi të kufizuar", në 2001 dhe rekomandimet e rishqyrtimit të RBB-së vitin e kaluar në Finlandë.

Në pjesën e pestë të po këtij kapitulli prezantohet:

Historiku dhe zhvillimi i RBB-së në Kosovë, me të gjitha përpjekjet gjatë 10 vite punë, në fillim me vullnetarët lokalë, PAK, familjarët dhe miqtë e tyre si dhe profesionistët lokalë si dhe asistenca e OJQ-ve ndërkombëtare si: Universiteti mbretëror, OPAK-ët ndërkombëtare të cilët dërguan profesionistë për përkrahje teknike dhe/ose financiare. Që nga viti 1999 Ministria e punëve të jashtme e Finlandës është ajo e cila na ka përkrahur në këtë drejtim.

Më parë PAK-ët kanë qenë të izoluar si pasojë e barrierave sociale, tradicionale dhe arkitektonike. Tani pas kaq viteve të punës për ngritjen e vetëdijes, edukimin, ndërtimin e kapacitetit,

42

III.VIZIONI PËR TË ARDHMEN – 1. Rishqyrtimi i kapitullit të dytë të broshurës

moralit, përkrahjes materiale dhe shërbimeve, këto barriera janë mënjanuar pjesërisht dhe fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuar kanë filluar të kyçen në shoqëri.

Kjo nuk ka qenë detyrë e lehtë, por sot mund të shohim se nuk ka qenë më kot. Rrejt i gjerë dhe arritjet e dëshmojnë këtë, por kjo nuk është e mjaftueshme, dhe do të duhet të kalohet edhe një rrugë (kohë) e gjatë derisa PAK-ët të përfshihen plotësisht në shoqëri.

Në pjesën e fundit të këtij kapitulli përmendim gjendjen serioze për qëndrueshmërinë e rrjetit të cilin HandiKOS-i e krijoi me një objektivë të vetme: ofrimin e përkrahjes psikologjike dhe materiale PAK-ve dhe familjeve të tyre si dhe shërbimet e rehabilitimit primar fëmijëve meqenëse për ta nuk ekzistonte asnjë lloj i shërbimeve rehabilituese.

Shqetësimi i Ministrisë së punëve të jashtme të Finlandës lidhur ardhmërinë e RBB-së në Kosovë dhe ardhmërinë e PAK ishte arsyeja për të bërë vlerësimin nga ekipi special nga Finlanda edhe atë duke filluar nga dhjetori i 2003 deri në mars 2004. Ky vlerësim është prezantuar kah fundi i pjesës së III-të të këtij materiali.

HandiKOS-i si pjesë e grupit punues mbi RBB-në është pajtuar plotësisht që për rehabilitimin fizikal dhe kujdesin shëndetësor të PAK-ve lidhjet me shërbimet shëndetësore janë absolutisht të nevojshme dhe se profesionistët në fizioterapi duhet të jenë përgjegjës për vlerësimin dhe përcjelljen e personave me dëmtime fizike si dhe për mbikëqyrjen e punëtorëve të kësaj fushe.

Në shumë shtete RBB-ja është pjesë e Ministrisë së shëndetësisë dhe kjo mund të jetë rast edhe në Kosovë, por rregullimi, implementimi dhe vlerësimi duhet të jenë multi sektorial. Kjo madje mund të jetë edhe garanci për pjesëmarrje dhe menaxhimin e buxhetit.

RBB-ja e zhvilluar 20 vitet e fundit dhe koncepti i Rehabilitimit dhe Rehabilitimit të bazuar në bashkësi, ashtu siç Einar Helander thotë në librin e tij “Paragjykimi dhe dinjiteti, prezantimi i rehabilitimit të bazuar në bashkësi”, tani ka një kuptim të gjerë.

Siç është përmendur paraprkisht, qasja e HandiKOS-it është multi-sektoriale dhe kjo është arsyeja pse prezantojmë këtë propozim si RBB kombëtare (Kosovare).

Implementimi i RBB-së ka nevojë për një strukturë në të gjitha nivelet: nivelin kombëtar, regional, komunal dhe të bashkësisë, ku me të vërtetë fillon me pjesëmarrjen e vetë PAK-ve dhe familjarëve të tyre. Shumë programe të RBB-së dështojnë për shkak se janë planifikuar jashtë bashkësisë, pa pjesëmarrjen e PAK-ve.

2. Korniza logjike e strukturës së RBB-së

NIVELI	PERSONELI	AKTIVITETET	KOMITETET	PERGJEGJ. E KOMITETEVE
KOMBËTAR			Komiteti Kombëtar i RBB- së Përfaqësues të të gjitha Ministrive e veçmas e ministrisë së: Shëndetësisë Arsimit Punës / Mirëqenies Sociale Rinisë- Sportit- Kulturës dhe OPAK-ve	1. Hartimin e politikave kombëtare të RBB-së 2. Koordinimin e aktiviteteve multisektoriale 3. Evaluimin e progresit të RBB-së 4. Koordinimin ndërkombëtar 5. Garantimin e buxhetit për Komitetin komunal të RBB-së
REGJIONAL (Referimi i dytë)	Spitali regjional: Ortopedi; neurologu; Psikiatri; Mjekësia fizikale dhe qendra e rehabilitimit Fiziatri, Fizioterapeuti, Ergoterapisti, Logopedi	<ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i shërbimeve specialitike PAK-ve të referuar nga nivelet tjera <ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i trajnimeve dhe mbikqyrjes teknike për punëtorët e rehabilitimit në nivel komunal dhe të bashkësisë 	Komiteti koordinues regjional Shëndetësi: Spitali dhe Qendra e rehabilitimit Trajnim profesional i R OPAK-ve	1. Mbikqyrjen e aktiviteteve të RBB-së në nivelin regjional 2. Koordinimin e aktiviteteve ndërsektoriale
KOMUNAL (Referimi i parë)	Punët. e rehabilitimit të nivelit të mesëm MLRV (Qendrat e komunitetit të HandiKOS-it).	<ul style="list-style-type: none"> Ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit parësor Referimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në nivelet më të larta apo sektoret tjera sipas nevojës Mësimin e prindërve të fëmijëve rreth AK të fëmiut të tyre dhe aktiviteteve që duhet bërë në shtëpi 	Komiteti komunal i RBB -së Përfaqësues të Ministrisë së : Shëndetësisë Arsimit Mirëqenies sociale Punës OPAK-ve Qendrat e bashkësisë së HK	1. Implementimin e politikave kombëtare 2. Mbikqyrjen e aktiviteteve të RBB-së në nivelin komunal :QB dhe bashkësia 3. Koordinimi i aktiviteteve të tyre sektoriale: a. Shëndetësia dhe rehabilitimi fizikal b. Arsimi Promovimin e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollë Ofrimin e transportit fëmijëve në shkollë Përmirësimin e përshtatshmërisë në shkollë dhe shërbime publike c. Mirëqenia sociale: Marrjen me pensionet për PAK d. Puna: Përfshirja e PAK në tajnime Promovimi dhe punësimi i PAK-ve 3. Asistimin e Komitetit të Bashkësisë 4. Promovimin e përfshirjes së PAK-ve në të gjitha ngjarjet: kulturore, sportive, etj.
BASHKËSIA	<ul style="list-style-type: none"> Punëtorët e bashkësisë (zyrat lokale të HandiKOS-it) Mjekët dhe infermierët e mjekësisë familjare 	<ul style="list-style-type: none"> Vizita shtëpiake, identifikimi i PAK-ve, ofrimi i informatave PAK-ve dhe familjarëve të tyre, ofrimi i informatave bashkësisë rreth shkaktarit dhe parandalimit të aftësisë së kufizuar, menaxhimi i pasojave dhe komplikimeve të aftësive të kufizuara: varrëve dekubitare, inkontinencës, referimit tek niveli më i lartë sipas nevojës. Përkrahja e punëtorit të bashkësisë në punën e tyre. Lehtësimin e integritetit të PAK-ve në jetën familjare dhe bashkësi. 	Komiteti i bashkësisë Përfaqësues: Mjeku/infermieri/ja Iimjekësisë familjare Punëtorët e RBB-së të HandiKOS-it. Shkolla Bashkësia PAK Prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuar	Mbikqyrjen e aktiviteteve të RBB-së në nivel të bashkësisë Përfshirjen e PAK-ve në jetën e bashkësisë Shqyrtimin e nevojave të PAK-ve Organizimin e aktiviteteve përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar Koordinimin e pjesëmarrjes së tyre në nivelin komunal, regjional dhe kombëtar Kërkimin sipas nevojës të përkrahjes nga niveli komunal

3. Strukturat e RBB-së

* **KOMITETIN KOMBËTAR TË RBB-së**:i përbërë nga të gjitha ministritë, veçanërisht nga:

- Ministria e shëndetësisë,
- Ministria e arsimit,
- Ministria e punës dhe mirëqenies sociale,
- Ministria e rinisë sportit dhe kulturës dhe
- Organizatat e personave me aftësi të kufizuar (OPAK-ët).

Përgjegjësitë e komitetit do të jenë:

- Hartimi i politikave kombëtare të RBB-së
- Koordinimi i aktiviteteve multi sektoriale
- Vlerësimi i përparimit të RBB-së në të gjitha regjionet dhe komunat
- Garantimi i buxhetit, me pjesëmarrjen e të gjitha Ministrive dhe përkrahjes nga jashtë sipas nevojës
- Mbajtja e koordinimit ndërkombëtar me agjencitë e KB dhe RBB-të tjera në botë.

* **KOMITETI RREGJIONAL I KOORDINIMIT** i përbërë nga:

- Spitali regjional
- Qendra e rehabilitimit
- Qendra regjionale për aftësim profesional
- OPAK-ët

Përgjegjësia e këtij komiteti do të jetë:

- Mbikëqyrja e aktiviteteve të RBB-së në nivel regjional
- Koordinimi i aktiviteteve ndër-sektoriale

Çelësi i suksesit të rehabilitimit të plotë të PAK-ve në rend të parë garanton shëndetin dhe rehabilitimin fizikal të tyre dhe në rend të dytë trajnimin profesional.

Spitali do të jetë pika referuese për PAK të cilët kanë nevojë për shërbime të specialistëve të ndryshëm si: kirurgu ortoped, neurologu, pediatri, etj. në opinionin e mjekëve të mjekësisë familjare të cilët punojnë në nivel komunal.

Mjekësia fizikale dhe qendra e rehabilitimit me profesionistët e tyre, fiziatrin, psikoterapeutin, logopedin, ergoterapeutin (në të ardhmen), kanë rol shumë të rëndësishëm në suksesin e RBB-së.

1. Mbikëqyrin punën e punëtorit të nivelit të mesëm në qendrat e bashkësisë.
2. Trajnimin e tyre sipas nevojës.
3. Vlerësimin e fëmijëve që ndjekin shërbimet në qendrat e bashkësisë dhe dhënia e këshillave profesionale punëtorëve të nivelit të mesëm për përcjelljen e aktiviteteve me fëmijët dhe me familjet e tyre.
4. Ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit të rriturve në vendin (zonën) e tyre dhe asistimin e punëtorëve të RBB-së të cilët përcjellin ata në shtëpi, dhënien e instruksioneve adekuate për këtë.

Profesionistët në nivel regjional mund të delegojnë këtë punë fizioterapeutit të Shtëpive kryesore të mjekësisë familjare, kur stafi do të jetë atje. Ashtu siç kemi propozuar në draftin e grupit punues të RBB-së. (Prill 2003) nga njësia e mjekësisë familjare dhe të rehabilitimit të Ministrisë së shëndetësisë.

Trajnimi profesional regjional është shumë i rëndësishëm për ndërtimin e kapacitetit të PAK, duke i përgatitur ata të bëhen pjesë e fuqisë punuese të shtetit dhe jo pjesëtar pasiv i shoqërisë, të varur nga pensioni.

*** KOMITETI KOMUNAL I RBB-së:**

Për implementimin e ligjeve dhe politikave të qeverisë në nivel komunal kemi përfaqësues të Ministrive të ndryshme. Në këtë nivel propozojmë komitetin e RBB-së të përbërë nga:

- Përfaqësues i departamentit të shëndetësisë
- Përfaqësues i departamentit të arsimit
- Përfaqësues i departamentit të punës dhe mirëqenies
- Përfaqësues i OPAK-ve
- Punëtori i nivelit të mesëm të rehabilitimit (HandiKOS-i)

Përgjegjësitë e Komitetit do të jenë:

- Implementimi i politikave kombëtare në RBB
- Implementimi i ligjit të shëndetësisë, mjekësisë familjare dhe sistemit referal
- Implementimi i ligjit të arsimit primar dhe sekondar, duke pasur kujdes të veçantë për kapitullin VII, që i referohet arsimit special
- Implementimi i ligjit për pensionet e PAK-ve
- Promovimi i përfshirjes së PAK në trajnime të ndryshme
- Promovimi i përfshirjes së PAK në të gjitha ngjarjet sportive dhe kulturore
- Implementimi i politikave që kanë të bëjnë me përshtatshmërinë e ndërtesave publike sipas rregullave standarde, për ndërtesat e reja.
- Koordinimi i aktiviteteve të të gjitha ministrive
- Mbikëqyrja e aktiviteteve të RBB-së në qendrat e bashkësisë dhe në terren (punëtorët e RBB-së)

*** KOMITETI I BASHKËSISË**

Ky komitet do të themelohet në fshatra me pjesëmarrjen e:

- Mjeku/infermierja e mjekësisë familjare
- Drejtori i shkollës/mësues
- Punëtori i RBB-së
- Kryetari i fshatit
- PAK-ët
- Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Roli i komitetit do të jetë:

- Mbikëqyrja e punës së punëtorëve të RBB-së në bashkësi
- Përfshirja PAK në jetën e bashkësisë
- Promovimi i vetëdijesimit rreth aftësisë së kufizuar në bashkësi
- Organizimi i aktiviteteve për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkolla dhe bashkësi
- Koordinimi i pjesëmarrjes së PAK në ngjarjet e nivelit komunal dhe regjional
- Kërkimi i asistencës nga Komuna, kur kjo është e nevojshme, për dhënien e informatave rreth shërbimeve të ndryshme (arsimimit, pensioneve, transportit)

Në këtë propozim përfshijmë politikat e rekomanduara nga Kombet e Bashkuara dhe Rregullat standarde mbi barazimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuar.

Për të pasur një RBB të fuqishme, efikase dhe efektive ekzistojnë dy komponenta kyçe: Pjesëmarrja e PAK/prindërve të fëmijëve e aftësi të kufizuar si dhe pjesëmarrja e të gjitha Ministrive të nivelit lokal dhe qendror. Vetëm puna së bashku bën të mundur arritjen e SHOQËRISË PËR TË GJITHË.

IV. Shtojcat

Shtojca 1 . Numri i përgjithshëm i PAK-ve

	Nr. i përgjithshëm "Sipas gjinisë"			Nr. i përgjithshëm "Sipas grupmoshave": 0 - 6, 7 - 17, 18 - 45, 46+			
	Femra	Meshkuj	Totali	Mosha: 0 - 6	Mosha: 7 - 17	Mosha: 18 - 45	Mosha: 46+
Deçan	240	293	533	18	79	216	220
Dragash	178	231	409	9	44	126	230
Fushë Kosovë	129	186	315	4	34	121	156
Ferizaj	266	339	605	20	112	237	236
Gjakovë	356	450	806	31	135	304	336
Gjilan	360	397	757	38	150	277	292
Glllogoc	330	361	691	35	113	259	284
Istog	205	241	446	15	72	175	184
Kaçanik	180	245	425	14	70	171	170
Kamenicë	181	232	413	18	55	128	212
Klinë	175	248	423	17	82	169	155
Lipjan	253	292	545	14	82	231	218
Malishevë	167	227	394	34	98	143	119
Mitrovicë	272	284	556	16	91	198	251
Obiliq	131	178	309	15	28	102	164
Pejë	350	341	691	25	128	239	299
Podujevë	340	480	820	24	123	314	359
Prishtinë	491	542	1033	39	216	409	369
Prizren	407	463	870	36	171	301	362
Rahovec	115	172	287	12	43	113	119
Shtime	99	146	245	7	44	80	114
Skenderaj	220	278	498	18	74	223	183
Suharekë	213	293	506	17	86	209	194
Viti	161	293	454	18	70	181	185
Vushtri	265	317	582	22	89	214	257
Totali	6084	7529	13613	516	2289	5140	5668

Shtojca 2 . Vizitat mjekësore të fëmijëve në qendrat e bashkësisë

Vizitat mjekësore, vlerësimet dhe referimet për fëmijët në qendrat e bashkësisë tetor-dhjetor 2002

Qendra	Nr. i femij	Paral. cereb	Hemi parezë	Paral. Erb	S. Down	S. Bifida	Polio	Dystro. Musk.	Të tjera	Kirurgj	Karrige	Longeta
Pejë	12	7	3					2		5	3	
Mitrovicë	13	6	2	2		1			2	8	3	
Prizren	8	2					3		3	1	1	
Vushtri	16	7	4		1	1			3	2	6	
Gjakovë	24	13	3	2		1		1	4	6	6	3
Ferizaj	21	12	3		1	3	1	1	1	7	5	1
Prishtinë	25	10	3		4	1		1	6	4	4	1
Gjilan	24	9	6	4		1			4	3	6	4
Drenas	16	4	11						1	3	3	1
Besianë	19	6	8	1					4	4	3	2
TOTAL	178	76	43	9	6	8	4	5	28	43	40	12

Vizitat mjekësore, vlerësimet dhe referimet për fëmijët në qendrat e bashkësisë 2003

Qendra	Nr.i femij	Paral. cereb	RPM	Hemi parez	S. Down	S. Bifida	Dystro. Musk	LCC	Paral. Erb	Polio	Te tjera	Kirurg. ortoped	Spec. ortop	Karrige	Q NOP	AD
Prishtine	78	35	11	12	7	1	3	4	1	1	7	11	4	13	4	4
Besiana	44	17	1	13	1	1	1	2	4		13	1		6	1	3
Drenas	78	17	11	23	6	3	4	1	1		18	8	8	7	2	6
Malisheva	43	16	13	6	1	1		7			2	5	9	8	4	
Mitrovica	31	13	4	2	1	1		1	3			8	3	6	1	2
Vushtri	19	11	1	8	2	1	1		1		6	3		6	1	
Peje	24	13	2	3	1			1	1		2	9	3	5	3	1
Gjakova	45	17	2	5	1	1	3	3	5	1	7	12	6	9	4	1
Gjilan	54	19	4	10		2	2	4	4		12	5	6	12	4	3
Ferizaj	50	21	6	8	6	5	1	3		1	2	12		13	3	1
Prizren	47	26	3	4	1		1	2	1	5	7	8	3	9	1	2
Suhareka	21	5	7	2	3	2					2	2	3	2		2
TOTAL	543	210	65	96	30	18	16	30	21	8	78	86	44	96	28	25

Vizitat mjekësore, vlerësimet dhe referimet me fëmijët në qendrat e bashkësisë 2004

Qendra	Nr.i femij	Paral. cereb	RPM	Hemi parez	S. Down	S. Bifida	Dystro. Musk	LCC	Paral. Erb	Te tjera	Kirurg. ortop	Spec. ortop	Karrige	Q NOP	AD
Pristine	25	16	12	2	1					3	4	7	2	1	3
Besiana	17	6	6		2	2		1		5	2	12	2	1	2
Drenas	16	4	5	3		1	1	1		3		4	1	2	
Malisheva	19	7	5	2	2	3			2	2	3	6	3	2	1
Mitrovica	12	7	2	3						1	1	4		3	2
Vushtri	14	5	6	2	1	2					1	4	3	1	
Peje	10	7	2	4								4	1	1	1
Gjakova	23	10	8	3	4		1	1		2	1	10	5	3	4
Gjilan	11	6	3		1				1	3		4	1	2	4
Ferizaj	23	11	6				1	3	1	3	3	3	3	6	1
Prizren	5	2		2						1		1	2	1	2
Suhareka	19	6	3	3		1		1		4		7	2		3
TOTAL	194	87	58	24	11	9	3	7	4	27	15	66	25	23	23

Bibliografia

- 1.- Shoqata e paraplegjistëve dhe paralizës së femijëve të kësaj të Kosovës: CBR programe towards handicapped people in Kosovo. 1996
- 2.- Shoqata e paraplegjistëve dhe paralizës së femijëve të kësaj të Kosovës, Handicap International: 'Seanca e ushtrimeve të Brendshme' Prishtinë, 1-2 March 1996.
- 3.-ICACBR: Development of CBR in Kosovo, Project proposal, Kingston, November 2000.
- 4.-ICACBR: Emergency assistance to the Disable Population in Kosovo, Albania and Bosnia - Herzegovina. July 1999.
- 5.-WHO/Rehabilitation: CBR and the health care referral services. 1994.
- 6.-Einar Helander: Prejudice and Dignity, an Introduction to CBR, second edition ,1999
- 7.-United Nations, Economical and social commission for Asia and the Pacific- Doc number-st/escap/1761: Understanding CBR. New York 1997
- 8.-Ronald Wiman: United Nations. The Disability Dimension in Development Action. Manual on inclusive planning. 1977.
- 9.- ILO, UNESCO, UNICEP, WHO : CBR for and with People with disabilities. Joint Position Paper. May 2001.
- 10.-UN civil Administration, Health and Social Services: Interim Health Policy Guidelines for Kosova and six month's action plan. Prishtina, September 1999.
- 11.-UN interim Administration, Department of Health and Social Welfare. Interim Health Policy Guidelines for Kosovo. Prishtina August 2000.
- 12.- Physical Medicine and Rehabilitation (PMR) Unit in Ministry of Health, based on outcomes from discussions held in the CBR Working Group, and WHO recommendations. "Draft Plan for Integration of CBR into the Primary Health care in Kosovo" 15. April 2003.
- 13.-Disability Task force: Comprehensive Disability Policy Framework. 3 December 2001.
- 14.- United Nations 85th Plenary Meeting 20.12.1993, A/RES/48/96: Standard Rules on the Equalization of Opportunities for Persons with Disabilities.
- 15.-Assembly of Kosovo: Law No.2002 /2. On Primary and Secondary Education in Kosovo. Date 31.10.2002
- 16.-Assembly of Kosovo: " Kosovo Health Law" . Law No.2004 / 4 Date 19.02.04
- 17.-World Federation for Physical Therapy: Briefing Paper No. 1"Primary Health Care and Community Base Rehabilitation" October 2003. (from Internet)
- 18.-Council for Advancing the Human Rights of PWD in Kosovo: "Report about the knowledge, respect and abuse of the Human Rights of PWD in Kosovo" Dec. 2001.
- 19.- Mr.Fitore Gashi: „Te drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë : Teoria dhe praktika“. Prishtinë, Shtator 2004.
- 20.- HandiKOS „Annual Report 2002“.
- 21.-STAKES team:Mission report on "The evaluation of the Finnish Support to the Disability Sector in Kosovo"Report to the Ministry for Foreign Affairs, Finland, 2

